

10-VJETORI I EKZODIT



Fillimi i pranverës që prej dhjetë vitesh për popullin e Kosovës shënon përvjetorin e vuajtjeve, përndjekjeve dhe terrorit, të cilin Evropa e kish harruar qysh nga mesjeta. Këtë terror nga faqet e errëta të historisë e riktheu dhe e bëri realitet makineria vrastare serbe dhe vetëm ata që e përjetuan në lëkurën e tyre zullumin mund të përshkruajnë se çfarë janë në gjendje të bëjnë ujqërit e veshur me petka njeriu. Ndërgjegjja (e krishterë) evro-perëndimore u provokua thellë atëbotë dhe deri në atë masë, sa që u vu në lëvizje aleanca më e fuqishme politiko-ushtarake për mbrojtjen e popullit të Kosovës dhe ndalimin e gjenocidit që ushtrohej mbi ta.

Që prej asaj dite kosovarët me mirënjohje të thellë e festojnë marsin si fillimin e ndërhyrjes ushtarake evro-perëndimore kundër aparatit serb të dhunës, duke e përjetuar këtë si ndihmë dhe përkrahje të fuqishme në kohën kur ndoshta më e logjikshme ishte të humbeshin të gjitha shpresat. Është interesant se mu atëherë kur ndoshta do të duhej që shpresat të mos ekzistojnë, mu atëherë ndodhin mrekullitë.

Sot pas dhjetë vitesh njerëzit vazhdojnë të bëjnë analiza rreth atyre ngjarjeve. Secili e manifeston përvjetorin në mënyrën e vet. Shqiptarët gëzohen që arritën ta gëzojnë lirinë, ndërsa në anën tjetër, serbët vajtojnë, akuzojnë, ngrenë zërin, por gjëja e vetme që akoma nuk e kanë bërë e që do të duhej ta bënin, nuk janë distancuar nga politikat dhe strategjitë vrastare millosheviqiane. Këtë e gjykojmë sipas retorikës që përdorin në të gjitha nivelet, por edhe nga veprime jo vetëm të individëve, që na japin të kuptojmë se nuk ka ndryshime konceptuale në mentalitet. Fatkeqësisht...

Unë mendoj për këtë ngjarje, se e ndiej nevojën që të flitet dhe të demaskohet terrori dhe gjenocidi medial dhe propagandistik që vazhdon të ushtrohet nga Serbia dhe në këtë drejtim të mobilizohen mekanizma mbrojtës, vendorë e ndërkombëtarë. Ç'është më e keqja, disa qarqe kosovare (me apo pa vetëdije) janë pozicionuar në të njëjtin tabor me qarqet antiislame dhe antishqiptare serbosllave. Etiketa, sensacione, afëra, skandale, të gjitha pjesë të fushatës donkishotiane që janë vënë në "shërbim" të mbrojtjes së civilizimit dhe kulturës evropiane nga rreziqet e fantazuara të terrorizmit, ekstremizmit, vehabizmit, e izmave të tjerë të fabrikuara nga makineria historikisht e dëshmuar si antishqiptare. Dallimi është vetëm në versione (serbisht, shqip) ndërsa brumi është i njëjtë. Prapë fatkeqësisht...

Nevoja për një ndërhyrje që do të ndalte këtë terror medial dhe këtë gjenocid kulturor është imediate. Mbesim në pritje të mrekullisë, pa i humbur shpresat...

Në emër të redaksisë:

Ekrem B. Avdiu

AKTUALE

Sfidat bashkëkohore të xhematit musliman **3-5**

Si ia le qyqja tia rrisë zogjtë tjetri **5-10**

KËNDI IM

Vetëpëlqimi **11-13**

Mosshpejtimi në dhënien e fetvave **14-17**

AKIDE

Të mësosh për zotin - mësimi më i vlefshëm **17-21**

FIKH

Paraja elektronike - Kartelat bankare (1/2) **22-26**

AVANCIMI PERSONAL

Mendimet që të tërheqin mbrapa? **27-32**

LIBRI

40 hadithe **32-34**

FAMILJA

Xhihadi i edukatës **35-38**

O motra, mësoni! **38-41**

TEFSIR

Zhvillimi i embrionit njerëzor (1/2) **42-47**

HADITH

Islami dhe kotësitë **48-50**

BOTA ISLAME

Republika e Burkina Fasos **51-52**

Republika e Çadit **52-53**

FETVA DHE KONSULTIME

Shprehjet e këqija dhe pasojat e tyre **54-56**

HISTORI

Kush lë një të keqe allahu i jep një të mirë **57-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor

Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI, Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI, Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: Albislam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: albislam@gmail.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

Xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.revista-albislam.com



SFIDAT BASHKËKOHORE TË XHEMATIT MUSLIMAN

Kush do të jetë prijësi i ardhshëm i Komunitetit Musliman, telashet e xhematit dhe cilësitë e një prijësi të munguar prej kohësh. Hallet e muslimanëve nuk mund të zgjidhen nga një simpozium i vetëm, por a duhet të tregohemi pasivë kundrejt të ardhmes tonë! Zgjedhje të kontestuara me një kandidat të vetëm zyrtar deri dy ditë përpara zgjedhjeve i lenë shteg akuzave me abuzime me statutin, si dhe tashmë ekstremizmi nuk importohet më nga arabët, por nga Maqedonia e Kosova.

SHKRUAN: ROALD A. HYSA

Një nga problemet më të rëndësishme që del përpara shoqërisë njerëzore është edhe zgjedhja e prijësve që do t'i udhëheqin dhe do t'i përfaqësojnë njerëzit apo kategoritë e ndryshme njerëzore, apo edhe Komunitetin tonë Musliman. Cilësia kryesore që i kërkohet një njeriu të tillë është që të jetë i kujdesshëm ndaj atyre që udhëheq dhe jo t'i shfrytëzojë ata në favor të vetes dhe lakmisë së ulët njerëzore. Gjatë këtij muaji që shkoi në Tiranë pati shumë tollovi rreth zgjedhjes së kryetarit të ri për Komunitetin.

Për të gjetur një të mesme të artë përpara zgjedhjeve u zhvillua një simpozium i posaçëm nga Këshillat e Xhamive pikërisht për sfidat e muslimanit shqiptar në një shoqëri tërësisht laike dhe që shpeshherë kalon në ekstrem duke abuzuar me ateizmin më vulgar të përfaqësuesve të saj. Simpoziumi ishte me të vërtetë shumë interesant për trajtesat e bëra nga folësit, të cilët i trajtuan me shumë kompetencë temat rreth këtyre sfidave. Të gjithë folësit në kumtesat e tyre ishin përpjekur të vendosnin raporte të drejta me realitetin ekzistues të muslimanëve shqiptarë me shoqërinë ku po jetojmë neve të gjithë sot. Ndërkaq lidhur me

agoninë e reagimeve të përfaqësuesve të Komunitetit Musliman lidhur me problemet me të cilat ndeshen muslimanët foli teologu **Justinian Topulli**. Ai bëri thirrje për një nevojë emergjente të një përfaqësimi të denjë, që do të largonte nga statusi aktual figurën e Komunitetit. Ai me argumente të shumta fetare solli në vëmendjen e dëgjuesve cilësitë që duhet të ketë lidhshipi musliman me thëniet profetike, të pasuruara me thëniet e kalifit të dytë të drejtë Omerit: “Nuk ka Islam pa një xhema, nuk ka xhema pa një udhëheqje dhe nuk ka udhëheqje pa bindje. Ai, të cilin populli i tij e vë në krye për të kuptuarin (fikhun) që ka, do të ketë jetë për vete dhe për të tjerët. Ndërsa, ai, të cilin populli i tij e vë në krye duke mos qenë i tillë, do të jetë shkatërrim për vete dhe për ta.” E gjitha kjo veprimtari mori ngjyrim të ndezura kur kujtojmë këtu se u krye në prag të zgjedhjes së kryetarit të ri të KMSH-së në Tiranë dhe njëkohësisht edhe pas akuzave të ngritura prej kohësh nga xhemati për abuzime me vakëfet dhe për drejtim të dobët. Nuk është e rëndësishme në këto ditë se kush do të zgjidhet si kryetar i KMSH-së, por e rëndësishme është se xhemati musliman akoma nuk ka arritur në nivelin e duhur të përfaqësimit të tij. Prandaj edhe ai që do të vijë në krye të Komunitetit Musliman në Shqipëri duhet të jetë i ndërjegjeshëm se me të vërtetë kohët kanë ndryshuar dhe për këtë duhet rritur niveli i përfaqësimit. E gjithë procedura e zgjedhjes së kryetarit të ri të KMSH-së u mbajt larg syve kuriozë të xhematit dhe publikut të gjerë. E vetmja gjë që dihej me siguri ishte kandidatura e **ing. Selim Muça**, i cili është edhe kryetari në fuqi i KMSH-së që prej 5 vjetësh. Akuza dhe kundërakuzat u shkëmbyen rëndom përpara zgjedhjeve të 21 marsit për kryetar. Një ndër to ishte se Kryetari i Komunitetit Musliman Shqiptar, Haxhi Selim Muça lëshoi alarmin nëpër mediet e Tiranës, se disa ekstremistë

“Nuk ka Islam pa një xhema, nuk ka xhema pa një udhëheqje dhe nuk ka udhëheqje pa bindje...”

kanë ardhur nga Kosova dhe Maqedonia, me qëllim për të përçarë Komunitetin Musliman Shqiptar. Ai përdori shprehjen: “**Këta që kanë ardhur nga jashtë janë më të ashprir, sepse të fusin shpatën**”, e me këtë kreu i KMSH-së ka lënë të kuptohet se gjithçka bëhet jo pa qëllim, por pikërisht për të sjellë një përçarje mes muslimanëve. Madje Muça ka shkuar deri atje sa ka deklaruar se ky sulm, ne dukje bëhet kundër tij, porse objekti i sulmit është pikërisht institucioni që ai drejton, duke u identifikuar ai vetë me institucionin që drejton. Ndërkaq një ditë përpara rizgjedhjes së kryetarit Muça dhe mbledhjes së Këshillit të përgjithshëm Kryesia e Komunitetit Musliman, i cilësoi deklaratat e kryetarit të saj si emocionale. E citojmë nga mesazhi i kësaj kryesie: “Debati që është hapur kohët e fundit në media, pavarësisht disa momenteve emocionale...” Ndërsa disa anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Musliman dorëzuan më 17 mars në gjykatën e rrethit të Tiranës, padinë civile kundër KMSH, duke u kërkuar togave të zeza të shpallin të pavlefshme mbledhjen e myftinjve në Kavajë, nga e cila do të dalë edhe kryetari i ardhshëm, gjithashtu një tjetër padi civile për shpifje ndaj ing. Selim Muça. Njëkohësisht u paralajmërua edhe një protestë, e cila u mbajt në Kavajë kundra kandidimit të z. Muça, dhe u zhvillua paqësisht nën kontrollin e forcave të shumta të rendit që shkuan posaçërisht nga Tirana për protestën. Protestat nuk e kanë tërhequr Muçën nga rikandidimi dhe fitorja e postit të kryetarit të Komunitetit, ndërkohë që ai ka pasur përballë vetëm një

rival **Sabri Hushin**. Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm u karakterizua nga debatet e shumta e deri në fyerje. **Ilir Hoxholli**, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të KMSH-së e kundërshtoi uljen e Selim Muçës në podium në mbarim të mandatit, disa ditë më parë. Hoxholli tha se është shkelur neni 22 për procedurën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja: “Duhej të ishim njoftuar 15 ditë para datës së mbledhjes. Këto zgjedhje janë një farsë. Është shkelur statuti i Komunitetit Musliman dhe ky i fundit nuk ka bërë transparencën për shumë nga akuza tonat, që nga shitja e vakëfeve përballë bustit të Azem Hajdarit në Tiranë, te Dhoma e Tregtisë e me radhë”. Jashtë godinës së Medresesë së Kavajës ku po zhvilloheshin zgjedhjet protestues nga Kavaja, Tirana dhe rrethe të tjera, mes të cilëve imamë xhamish dhe besimtarë të thjeshtë, së bashku me familjet e tyre kanë vijuar protestën. Ata kanë protestuar paqësisht kundër kandidaturës së Muçës, mënyrës së zgjedhjeve dhe mungesës së publikimit të platformave të kandidatëve për Komunitetin. Raporti i punës i Kryesisë së KMSH u lexua nga ana nënkryetarit të KMSH **z. Saimir Rusheku** dhe u vazhdua me diskutimet rreth këtij raporti. Kandidati **Karafil Manaj** u tërhoq para se të kalohej në votim. Më pas u kalua në votim, për dy kandidatët e mbetur, ing. Selim Muça dhe Sabri Hushi, ku pas numërimit të votave nga rezultati doli fitues Selim Muça me 68 vota, ose 85% e tyre, duke udhëhequr kështu KMSH-në edhe për një mandat tjetër 5 vjeçar. Kështu u mbyll telenovela trejavore e zgjedhjeve të KMSH-së, ku edhe një herë u shfaq mostoleranca e brendshme ndaj zërave kundër.

SI IA LE QYQJA TIA RRRISË ZOGJTË TJETRI

(TRASHËGIMIA E PRESIDENTIT DËSHTAK... PËR PRESIDENTIN E RI NJOMËZAK)

Xhorxh Bushi (biri) që ishte i pasjellshëm ndaj Amerikës do t'i lërë vendit – krahas fatkeqësisë së Gazës – një zinxhir krizash dhe tufa gjembash të helmuara, për t'u vendosur në qafën e idhullit të lirisë, që ndoshta nga penda e një gjembi të shkruihen faqet më të zeza në regjistrin e historisë së ardhshme amerikane

EDITORIALI I REVISTËS “AL BAYAN”¹

Zjarri i Gazës me gjithë ndikimin dhe famën e zezë do të jetë kësti i fundit nga trashëgimia e prishur, të cilën ia la **Xhorxh Bushi** pasardhësit të tij **Barakut** amerikan, por që mbi arkën e këtij kësti qëndron mbishkrimi i Barakut të Izraelit, dhe kështu i gjithë njerëzimi do ta kuptojë realitetin e fjalës së urtë: “Kush e ndihmon zullumqarin, vetë e pëson mbi kokë”. Akoma kjo Amerikë bashkë me grupin tiran ndihmon mosbesimin dhe zullumin, por njëherësh e detyron botën që të heshtë për krimet dhe barbarizmin e saj, madje edhe nëse vjen në kundërshtim me të gjitha kodet humane

¹ Shkurt 2009



dhe traditat ndërkombëtare.

Rezultatet e luftës ndaj Gazës do të jenë një shtesë e re në llogarinë e falimentit amerikan, duke e përshkruar si një fuqi e madhe, akoma e respektuar botërisht. Me largimin e njeriut të parë nga posti “kryetar i botës” në datën 20. 01. 2009, Xhorxh Bushi do të jetë kryetari i parë amerikan që braktisi Amerikën dhe botën në kriza të përsëritshme dhe rrënjësore, jo vetëm në nivel amerikan por në nivel botëror përendimor.

Xhorxh Bushi (biri) që ishte i pasjellshëm ndaj Amerikës do t'i lërë vendit – krahas fatkeqësisë së Gazës – një zinxhir krizash dhe tufa gjembash të helmuara, për t'u vendosur në qafën e idhullit të lirisë, që ndoshta nga penda e një gjembi të shkruhen faqet më të zeza në regjistrin e historisë së ardhshme amerikane.

Shoqëria amerikane nuk arriti të gëzohet me udhëheqjen e Bushit, për ta çuar botën e krishterë drejt Perandorisë Botërore të shekullit 21, të cilën deshi ta ngrrej mbi kafkat e muslimanëve, duke luftuar kundër tyre, me pasuri dhe me shpirt. Gjithashtu Amerika, aleatët e saj tiranë dhe paraardhësit e tyre mendjemadhënj nuk arritën të

kënaqen me suksesin e programit të çifutëve të rinj në “projektin e shekullit amerikan”. Po ashtu Bushi nuk pati fat të arrijë suksesin për të realizuar projektin “Lindja e Mesme e Madhe”.

I ngratë është kryetari i ri, “fitimtari” mbi dështimet amerikane në çdo fushë, i cili prapë se prapë e përgëzon popullin se ka fuqi për t'i tejkaluar të gjitha këto kriza! I humbur është kryetari i dështuar (Xhorxh Bush), i cili deri në ditën e fundit të udhëheqjes, me inat dhe me këmbëngulje deklaronte se epoka e tij ishte epokë e realizimeve dhe e fitoreve! Mos vallë Xhorxh Bushi mendoi se muslimanët nuk kanë asnjë vlerë te Zoti, që qafirët t'i nëpërkëmbin, apo mendoi se do t'i lërë në duart e të humburve dhe të atyre ndaj të cilëve Allahu është i zemëruar pa u hakmarrë për ta?

Mos vallë shpresonte që të silltet në këtë tokë të shtruar me ligjin e mendjemadhësisë pa pasur frikë nga goditjet natyrore, të cilët ia fshijnë karizmin në sytë e botës, siç ndodhi në “betejën e këpucëve”, por siç ndodhi më herët edhe me Karunin, Hamanin dhe çdo mendjemadh tjetër inatçi.

Kur shohim trashëgiminë e Bushit, i cili

“Obama nuk ka fuqi – siç pretendoi – t’i qetësojë punët në ato vende ku planifikon, sepse budallallëqet e Bushit do ta ndjekin vazhdimisht Amerikën edhe shumë vite ...”

tashmë ka hyrë në harresë, të cilën ia la pasardhësit të tij të tronditur dhe të hutuar nga ajo që fshehin ditët në vazhdim, ne e madhërojmë Allahun duke thënë: I Lartmadhëruar është Allahu, që ka thënë **“Ato janë vetëm ditë që Ne i ndërrojmë midis njerëzve”**. (Ali Imran 41), më pas e lusim Allahun që ndërrimin dhe ditët në vazhdim – pas izolimit të Amerikës dhe përfundimit të epërsisë së saj – t’i takojnë popullit më të mirë që ka dalë për njerëzimin. Kjo për Allahun nuk është e rëndë. Kush e mendonte se Amerika do të bjerë në këto kriza në më pak se dhjetë vjet?

Skena e hidhur e Bushit:

Le të shohim filmin e largimit të Bushit, se si i dorëzoi çelësat e Shtëpisë së Bardhë nga “kutia e zezë”, e cila u gjet midis rrënojave të administratës së neo-konservatorëve, të cilët së bashku me Bushin po futen në varrin e historisë. Ja kështu:

Fillimisht: Dështimet ushtarake:

Ato janë syresh në pamje dhe në shkallë të ndryshme. Bushi i ndezi fitilat e saj, ndërsa Obama nuk ua di fundin. Nga dështimi në Irak, drejt nënçmimit me robërit në Afganistan, drejt regresit në Somali, drejt përruljes dhe frikës në çështjen e Iranit dhe Sudanit, deri te prishja e raporteve në Palestinë! Kështu Obamës i mbeti për detyrë

të menaxhojë këto dosje të nxehta deri në kulm, të cilat nuk duken se do të ftohen, sado që t’i ketë të ftohta nervat e tij e as të shuhen, sado që mundohet t’i largojë flakët e tyre nga Amerika dhe populli i saj, sepse këmbët të cilat u çuan për të mbrojtur nderin dhe Fenë nuk durojnë të ndalen në gjysmë të rrugës vetëm pse erdhi një kryetar i ri në Shtëpinë e Bardhë, sidomos nëse edhe djalli i këtij e mëson të punojë njësoj si paraardhësi i tij.

Çfarë mund të bëjë Obama me ushtritë e përfshira në konfliktet në Irak dhe Afganistan dhe shumë të tjera që janë të mbyllura nëpër baza ushtarake në vende të ndryshme, sepse ato tashmë kanë nevojë për përkrahje financiare të vazhdueshme, të cilat arrijnë dhjetëra miliarda dollarë në muaj në këtë situatë krize financiare, gjë e cila do ta bëjë popullin amerikan të mjerohet për çdo dollar që derdhet jashtë kufijve?!

Ka probleme akoma të tjera në fushën ushtarake që e presin Amerikën. Pritet një problem i madh për Obamën në vijën kufitare Afganistan – Pakistan, sepse fiset vendase nuk pranuan përruljen dhe as përçmimin para fraksionit Ismailit, i cili grabiti pushtetin në Pakistan. Gjithashtu ai pret edhe episodin e fundit të luftës në Irak, stinët e së cilës akoma nuk kanë mbaruar në atë vend të tradhtuar, i cili do të ngrihet medoemos kundër atyre që e tradhtuan d.m.th., kundër amerikanëve dhe agjentëve iranianë. Obama nuk ka fuqi – siç pretendoi – t’i qetësojë punët në ato vende ku planifikon, sepse budallallëqet e Bushit do ta ndjekin vazhdimisht Amerikën edhe shumë vite pas largimit të tij, madje edhe më shumë se kjo, ndoshta SHBA-së po i afrohet koha për ndarje dhe copëtim për shkak të kurtheve që u bëri muslimanëve, ashtu siç i ndodhi edhe zullumqarit të mëparshëm, Bashkimit Sovjetik.

Së dyti: Zmbrapsjet politike:

Obama e gjeti veten përpara situatave të

reja, që ia imponojnë Amerikës të përballet me vështirësi të ndryshme me fuqi të llojllojshme, si dhe metoda e strategji të shumta, të cilat dallojnë në çdo gjë, përpos asaj që Amerika duhet të mbetet e vetme në udhëheqjen e botës, e cila po e çon drejt kolapsit të madh politikën amerikane, si dhe drejt kolapseve të tjera dytësore në çdo vend të botës. Tani po shfaqet kriza e mosbesimit me Rusinë, e cila kanos kthimin e luftës së ftohtë me te. Ajo ka mospajtime me Evropën apo me disa prej shteteve të mëdha evropiane për shumë këndvështrime që kanë të bëjnë me krizat ndërkombëtare, si dhe shumë kriza jashtëzakonisht të mëdha që imagjinohet të ndodhin në shumë prej vendeve ku Amerika ka interesat e saj, sepse tashmë edhe ato vende e zbuluan se kalorësit amerikanë janë duke vrapuar drejt humbjes!

Së treti: Fatkeqësitë ekonomike:

Nuk mund ta ndajmë këtë nga dy pikat e mëparshme. Asnjëri nuk mund të sjellë ndonjë argument se dështimet ushtarake të Bushit – sidomos në Irak dhe Afganistan – nuk patën ndikim në fuqinë ekonomike të Amerikës, harxhimet e të cilave në fund të mandatit të tij arritën në 7972 miliardë dollarë, mirëpo tani Obama kërkoi edhe 70 miliardë shtesë, për ta mbajtur nivelin në këto dy fusha të ndezura, harxhimet e të cilave tashmë po tejkalojnë një trilion dollarë. Dihet mirëfilli se kur ndodhi kriza financiare amerikane, ajo menjëherë u bë botërore dhe Amerika u detyrua të nxjerrë nga magazina federale me qindra miliardë dollarë për t'i shpëtuar bankat dhe kompanitë e mëdha që po rrënoheshin. Bushi kërkoi 700 miliardë dollarë, pas tij Obama kërkoi 800 miliardë të tjera! Si do t'ia bëjë hallin Amerika e rënë në krizë financiare dhe e dështuar ushtarakisht t'i kapërdijë këto harxhime marramendëse? Si ëndërron që ajo të mbetet fuqia e parë financiare botërore?! Ekspertët thonë:

“...Buxheti i Bushit për të luftuar – siç thoshte – terrorizmin, deri tani i ka kushtuar Amerikës katër fish më shumë, sesa ka harxhuar gjatë Luftës së Parë Botërore...”

Buxheti i Bushit për të luftuar – siç thoshte – terrorizmin, deri tani i ka kushtuar Amerikës katër fish më shumë, sesa ka harxhuar gjatë Luftës së Parë Botërore, si dhe dhjetë fish më shumë, sesa ka harxhuar në Luftën e Gjirit, në vitin 1991. E tëra kjo vetëm për të shuar dritën e Islamit, por më kot... sepse Zoti i qiejve dhe i tokës thotë: *“Ata që nuk besuan shpenzojnë pasuritë e tyre për të penguar nga rruga e Allahut. Ata do t'i harxhojnë ato, por ajo do të bëhet dëshpërim për ta dhe pastaj do të mposhten”*. (Ali Imran 36). Çka do të bëjë Obama para luzmës së bumit, i cili ka trokitur në dyert e bankave të Amerikës dhe pastaj vazhdoi fluturimin drejt bankave evropiane?

Disa thonë: Krizat e Amerikës nuk kanë asnjë lidhje me luftën ndaj muslimanëve, prandaj mos u dalldisni... ne themi: edhe po të ishte ashtu, Amerika nuk i shpalli luftë vetëm muslimanëve, me të cilët e humbi luftën, por ajo – para tyre – i shpalli luftë Zotit të tyre, prandaj meritoi një luftë që nuk ka shembull, sepse ekonomia kapitaliste amerikane – e themeluar mbi kamatë – sikurse ekonomitë e tjera perëndimore, ishin dhe vazhdojnë të jenë në luftë kundër Allahut. Kush është pra ai i poshtër, që mund të qëndrojë në luftë me Allahun?! Mos vallë “Bushit fetar” me grupin e tij të Biblës (Inxhilit) dhe aleatët e tij të Toras (Teuratit) nuk e kishin zbuluar se kamata është e ndaluar, edhe në kopjet e Inxhilit të

shtrembëruar, edhe në komentet e Teuratit të falsifikuar!

Ishte normale që myslimanët të presin ligjet e Allahut të veprojnë mbi ta dhe të përjetojnë dënimin hyjnor kundër tyre: “...e nëse nuk largoheni (nga kamata) **atëherë priteni luftën nga Allahu dhe i Dërguari i Tij**”. (Bekare 279); “**Allahu ia heq kumatës çdo përfitim, ndërsa e shton sadakanë**”. (Bekare 276). Mirëpo ja që njerëzit me këmbëngulje – si duket edhe Obama do të këmbëngulë – vazhdojnë rrugën e humbur, duke thënë (sikur ata që thanë): “**Zemrat i kemi të mbuluara**.” (Nisa 155). Për atë shkak u mallkuan jobesimtarët çifutë nga goja e Davudit dhe e Isait dhe për atë arsye u dëbuan nga mëshira, sepse merrnin kumatën që u ishte ndaluar dhe hanin pasurinë e njerëzve me padrejtësi.

Çfarë pret Obama apo të tjerët nga kjo luftë e hapur e Allahut kundër atyre që e kundërshtuan, luftë e cila po paralajmëron dhe po qorton amerikanët, evropianët dhe të gjithë ata që ecin nëpër këtë rrugë armiqësore kundër Allahut dhe ligjeve të Tij, në formën e “krizës ekonomike”? Po e quajnë me këtë emër, ndërsa po harrojnë se kjo është luftë ndaj së cilës Amerika apo Obama nuk ka mundësi të triumfojë, sado që të armatoset me arsenal bërthamor apo me fuqi të tjera ushtarake.

I vetmi shans për amerikanët, evropianët dhe për të gjithë që ecin asaj rruge është marrja seriozisht e këtyre paralajmërimeve dhe qortimeve. Por ja që paralajmërimet dhe qortimet nuk i bëjnë punë popullit që nuk beson!

Së katërti: Rënia intelektuale dhe kulturore

Pa pasur vlera nuk mund të vazhdojë udhëheqja e botës, si dhe pa mendime të shëndosha me afat të gjatë dhe të afërt, shejtani e mbisundon njeriun. Xhorxh Bushi shkatërroi ndërtesën e vlerave të

pretenduara amerikane tullë pas tulle, saqë nuk mbeti nga ajo ndërtesë as minimumi, i cili së paku do të vlente për marketing dhe pretendim. Administrata e tij gjithashtu vendosi t'i shpallë luftë të gjitha ideve që kundërshtohen me liberalizmin, gjë e cila solli një dridhje të ashpër, e cila lëkundti thelbin e asaj që njihej si “vlera” amerikane dhe i shkapërderdhi zinxhirët e liberalizmit kapitalist. Atëbotë kur ai mori postin e kryetarit në Amerikë, vendit nuk i ishte harxhuar akoma krediti i epërsisë intelektuale dhe kulturore, para syve të disa të mashtruarve dhe të neglizhuarve. Mirëpo rezultati i luftës kundër mendimit ndryshe, i dha fund përrallës së zbukuruar që nga disa dekada me radhë dhe zbuloi fytyrën e vërtetë të këtij qytetërimi, i cili mbahet me sjellje kaubojsh (çobanë lopësh).

Bushi i zhveshi ca gjëra nga turpi i kaubojit egoist, kapitalist, i cili po sjell miliona viktima në këtë kohë kur kapitalizmi e ka përfshirë botën, të cilat Obama nuk ka mundësi t'i mbulojë. Sjelljet personale të Bushit shfaqën realitetin e “vlerave” të atij populli liberal, i cili e shenjtëron lirinë. Kjo u pa në kampet e fshehta dhe ato publike të burgut, ndyrësia e të cilave akoma nuk është e qartë, përveçse pak. E vërteta e plotë ka mbetur e cunuar brenda mureve sekrete në burgjet amerikane të lirisë, si në **Guantanamo** (Kubë), **Ebu Graib** (Irak) dhe **Xhanxhi** (Afganistan), ndërsa këtë të fundit SHBA vendosi ta bëjë qendrën më të madhe të të burgosurve, në vend të Guantamos dhe në këtë projekt do të ndihmojë gjithashtu edhe qeveria irakiane shiite!

Lufta e Bushit kundër mendimit ndryshe e pësoi njësoj si betejat e tij ushtarake, saqë edhe planifikuesi i dështuar i atyre politikave **Donald Ramsfeld**, në një prononcim të tij, më 16 Shkurt 2006, e pranoi dështimin e shpejtë dhe të hatashëm, se Amerika humbi luftën e shpallur kundër atyre që i emërtoi: radikalët

islamikë, duke deklaruar: “Duhet të gjejmë metoda të tjera për të fituar zemrat dhe mendjet e njerëzve në botën islame, sepse radikalët korrën sukses në helmimin e mendimit për Amerikën”.

Bushi, gjithashtu arriti sukses te çelë kapakun e barbarizmit të qytetërimit perëndimor, nëpërmjet operacioneve të bojkotit, pas të cilave për çdoherë pasonte hapja e dyerve të xhehenemit dhe zjarrit për shumë popuj që deri atëherë jetonin në paqe. Përparimtarët amerikanë e bojkotuan Irakun për më shumë se dymbëdhjetë vjet, gjë e cila shkaktoi vrasjen e gati një milion fëmijëve, krahas viktimave ndërmjet të rriturve. E shfrytëzuan këtë njerëzit e ngurtë për ta kthyer vendin në kohën e gurit, gjithashtu edhe ziliqarët dhe smirëzinjtë arritën ta shndërrojnë Afganistanin në grupe kaçakësh dhe të zhvillojnë tregtinë e drogës. Gjatë tërë pushtetit të talebanëve, sjellësit e përparimit, drejtësisë dhe lirisë së vërtetë nuk arritën të ndërtojnë deri në fund një vend islam, që do t'i praktikonte ligjet e sheriatit islam, në mënyrë që pas atyre betejave të gjata, të rrënjoste bazat e drejtësisë, të nxirrte në pah thelbin e sigurisë dhe të hapte dyert e shpresës për një jetë të lirë, të ndershme dhe të qëndrueshme. Mirëpo, ja që bojkoti gllabërues vazhdoi pesë vite të tëra, aq sa qëndruan në pushtet Talebanët, pastaj Amerika u shpalli luftë atyre, gjë e cila ishte vendosur disa muaj më parë se sa ngjarjet e 11 Shtatorit.

Më në fund erdhën ngjarjet e Gazës për t'i qartësuar të mençurve të botës – nëse pas këtyre ngjarjeve akoma u kanë mbetur mend – sesi qytetërimi demokratik amerikan, i cili deshi të pushtojë alemin me vlerat e tij, po tregon një shpirtngushtësi për të pranuar lirinë e Palestinës së okupuar, madje e mallkoi dhe e luftoi kur vërejtë se liria po zë vendin më të lartë në këtë vend, i cili u sprovuua me tradhtarë. E gjithë bota e kuptuan sesi

Amerika me tradhtarët vendas hartuan ndezjen e fitnes dhe bojkotin total ndaj atyre që zgjodhën lirinë, e kuptuan sesi çifutët e tërbuar mbisunduan mbi ta, e kuptuan sesi në flakën më të madhe të luftës kundër të dobëtëve, i ndihmuan duke u dërguar kamionë plot me armë moderne të zhvilluara dhe të sofistikuara, që shprehin edhe arritjet më të fundit të zhvillimit dhe përparimit, të cilat Amerika ua kushton popujve të Lindjes së Mesme të Re.

Supozimi ynë është: Përderisa këto ide dhe “vlera” të këtij qytetërimi brutal janë në pedestal, dhe me pëlqimin e vet popullit amerikan, atëherë epoka e ardhshme e udhëheqjes nuk do të ndryshojë shumë nga epoka e gjenocidit kundër indianëve lëkurëkuq. Kjo paralajmëron se zmbropsja amerikane nga vija e parë e qytetërimit botëror do të rritet akoma edhe më shumë.

Ndërsa kryetari trashëgues Obama, me këtë trashëgimi fatkeqe është i detyruar para dy zgjedhjeve të vetme; me secilën prej tyre do të përballet, po ashtu edhe me shumë kriza e fatkeqësi.

Një: Të luajë me popullin e tij – siç bënte Bushi – lojën e mashtimit dhe të hiles, duke i përshkruar dështimet si fitore dhe zmbropsjet si realizime!

Dy: Të presë nga populli i tij fundin me vrasje apo atentat, sepse amerikanët do të supozojnë se demokratët me ngjyrë janë shkatërrimtarë të vendit, e në radhë të parë të Shtëpisë së Bardhë më shumë sesa Bushi, që shkatërroi gjatë epokës së tij të zezë!

Që të dyja rrugët, hilja apo ikja, do të hapin para amerikanëve dyert e fitnes, betejave dhe zjarreve, mu ashtu si i hapën ata në vendet muslimane. *“Dhe thuaju atyre që nuk besojnë: “Ju bëni çfarë të mundni, edhe ne do të bëjmë çfarë të mundim, dhe pritni, nëse do të prisni, se dhe ne do të presim!”* (Hud, 121-122). ■

Përktheu: Omer Berisha

VETËPËLQIMI

Në shumicën e rasteve viktimat e vetëpëlqimit janë të dalluarit në ndonjë lëmi të dijes, apo në ndonjë fushë të veprimit, të vetëdijshmit për cilësitë e tyre që si zakonisht janë: dija, pasuria, bukuria, trimëria dhe të ngjashmet

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

Biseda rreth këtij vesit nuk është e rastit dhe s'mund të jetë e rastit. Si duket, jetojmë në një kohë në të cilën theksimi i të "gjithë aftësive" individuale dhe harresa "selektive", që përfshin dobësitë është bërë mënyra e vetme e vetë-prezantimit dhe e vetë-vlerësimit.

Pranimi i vetëpëlqimit në shumë/të gjitha sferat e jetës sonë individuale dhe shoqërore është një realitet i pamohueshëm. Rreshtat që po shkruaj rreth kësaj teme nuk janë rezultat i ndonjë studimi sistematik dhe rigoroz nga aspekti logjik. Ato më tepër do t'i quaja shtjellim pragmatik, rezultat i inspirimit momental i shprehur me gjuhën e një vëzhguesi/pjesëmarrësi, që synon të kontribuojë në largimin e tij nga jeta e muslimanëve.

Në ajetin që flet për dështimin fillestar të muslimanëve në betejën e Huneinit, i Madhëruari në tokë dhe qiej thotë: ***"Në të vërtetë, Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, si dhe në ditën e (luftës së) Huneinit, kur juve ju mahniti numri juaj i madh. Por ai numër nuk ju sollti dobi aspak, sepse toka ju duk juve e ngushtë, edhe pse është e gjerë dhe kthyet shpinën duke ia mbathur"***. (Teube, 25)

Vetëm një çast dobësie dhe mahnitje me numrin e madh të muslimanëve që përballëshin me një ushtri numerikisht më të vogël mjaftoi, dhe toka e gjerë u bë e

ngushtë. Kurtubiu, Allahu e mëshiroftë, duke e komentuar pjesën e ajetit ***...kur juve ju mahniti numri juaj i madh...*** thotë: Disa prej tyre thanë: Nëse sot pësojmë disfatë shkak nuk do të jetë numri i vogël i



ushtarëve tanë.

Vetëm kjo fjali, nga e cila që prej së largu mundet të nënkuptohet, se tek sahabët ekzistonte mbështetja vetëm tek lidhshmëria shkakësore mes numrit të ushtarëve dhe fitores në betejë ishte shkak i disfatës në fillim të betejës. Nëse duke e analizuar këtë fjali, me një shkallë vlerësimi prej një deri në dhjetë (minimumi njëshi, ndërsa maksimumi dhjeta) sikur ta masim këtë vetëbesim dhe vetëmburrje tek sahabët, që e përjetuan këtë ndodhi, me siguri që shumica atë do ta vlerësonin me një notë të ulët. Pikërisht këtë vetëbesim, nga kjo distancë kohore i vlerësuar me “kriteret” tona si i ulët dhe i pahetueshëm, Allahu e emëroi si vetëpëlqim dhe e ka nxjerrë si shkak për disfatë.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ndërmjet veseve shkatërrimtare për njeriun përmend edhe vetëpëlqimin. Ai thotë: *“Tre gjëra janë shkatërruese: epshi i pasur, koprracia së cilës i nënshtrohemi dhe vetëpëlqimi i njeriut me mendimin që e ka”*.

Ebu Thalebe Husheni, Allahu qoftë i kënaqur me të, shkoi tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, dhe e pyeti për ajetin: ***“O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë.”*** (Maide, 5). I Dërguari i Allahut tha: *“E ke pyetur atë që ka njohuri për këtë, urdhërohuni në të mira dhe ndaloni nga të shëmtuarat deri sa të mos shihni koprraci së cilës njerëzit i nënshtrohen, epshe të pasuara, dhënie përparësi dynjasë dhe vetëpëlqim i njeriut me mendimin që e ka. Atëherë kujdesuni vetëm për veten dhe largohuni nga popullata, sepse do të vijnë ditë në të cilat durimi do të jetë si kapja e gacës. Ai që në atë kohë bën të mira do të ketë shpërblimin e pesëdhjetëve që bëjnë*

“... Vetëpëlqimit mundemi t’i shmangemi nëse i dimë shkaqet e tij. Injoranca është shkaku i parë i vetëpëlqimit...”

vepra si tuajat.” (E përcjell Tirmidhiu, hasen)

Ibën Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: Shkatërrimi është në dy gjëra; në humbjen e shpresës (nga mëshira e Allahut) dhe në vetëpëlqimin. Asnjëri prej tyre nuk angazhohet dhe nuk kërkon (falje). Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: Vetëpëlqimi është e kundërta e së drejtës dhe është dështimi i të mençurve.

Mutarrifi thotë: Ta kaloj natën në gjumë (pa u falur) dhe të gdhihem me pendim është më e dashur për mua, se sa ta kaloj natën në adhurim dhe të gdhihem me vetëpëlqim.

Bishër b. Mensuri ishte prej atyre që ta kujtonin Allahun dhe ahiretin. Një ditë pasi u fal gjatë e pa një njeri që po e priste dhe i tha: Mos u mashtro me atë që pe. Iblisi, qoftë i mallkuar, për një kohë të gjatë bëri ibadet së bashku me melekët dhe pastaj përfundoi ashtu si përfundoi.

Imam Gazaliu duke e përkufizuar vetëpëlqimin thotë: Vetëpëlqimi është mbivlerësimi i një mirësie që ka njeriu dhe mos-përshkrimi i saj Dhuruesit (Allahut). Një dijetar tjetër i këtij Umeti thotë: Vetëpëlqimi është mburrje me vetveten, zmadhimi i punëve të bëra dhe mbështetja në to, mosnjohja e tyre Dhuruesit (Allahut). I sprovuari me këtë ves ballafaqohet me mospranimin e veprave, me fshehjen e cilësive të mira dhe me kritikën që i shprehet prej njerëzve.

Vetëpëlqimi është i ndaluar, sepse është

një formë e shirkut. Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: Shpeshherë shtirjes i bashkëngjitet vetëpëlqimi. Tek shtirja (puna për sy e faqe) krijesat ngrihen në piedestalin e hyjnisë para së cilës shtiremi, ndërsa tek vetëpëlqimi ajo ndodh me vetveten. Shtirësi nuk e realizon pjesën e ajetit: **Vetëm Ty të adhurojmë**, ndërsa tek vetëpëlqimi nuk realizohet: **dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë**. Ai që në jetën e tij arrin ta zbatojë ajetin: **Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë** do të shpëtojë nga rijaja dhe vetëpëlqimi.

Në shumicën e rasteve viktimat e vetëpëlqimit janë të dalluarit në ndonjë lëmi të dijes, apo në ndonjë fushë të veprimt, të vetëdijshmit për cilësitë e tyre që si zakonisht janë: dija, pasuria, bukuria, trimëria dhe të ngjashmet. Sipas Ibën Kudames relacionet e njeriut me begatinë që e ka shfaqen në tre forma:

Forma e parë: që njeriu të frikësohet se mos e humb atë cilësi me të cilën dallohet dhe kjo nuk quhet vetëpëlqim, sepse njeriu që frikësohet nga humbja e ndonjë cilësie që ka, nuk mbështetet në të.

Forma e dytë: Të mos frikësohet nga humbja e cilësisë së mirë që ka, por të gëzohet me të duke e ditur se është begati prej Allahut. Edhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me vetëpëlqim, sepse njeriu në fjalë nuk ka harruar se këtë cilësi e ka dhunti prej Allahut.

Forma e tretë: Atë e gjejmë tek njeriu, i cili nuk e merr në konsideratë mundësinë e privimit të tij nga cilësia që ka. Atë cilësi nuk e shikon nga aspekti i dhuntisë hyjnore. I njëjti njeri gëzohet me këtë cilësi dhe mbështetet plotësisht në të. Atë nuk e sheh si mirësi prej Allahut dhe nuk e mendon se ndonjëherë ka mundësi që ta humbë atë.

Pasojë e vetëpëlqimit është

mendjemadhësia, e cila shfaqet me refuzimin e së vërtetës dhe përçmimin e njerëzve. Maverdiu thotë: Vetëpëlqimi i fsheh mirësitë, i shfaq mangësitë, bëhet shkak për kritika dhe të largon nga gjërat e vlefshme. Urrejtja e shkaktuar nga mendjemadhësia nuk ka kufi dhe injoranca drejt së cilës të çon vetëpëlqimi nuk ka skaj. Të sprovuarit me këtë ves i harrohen të mirat dhe i përhapen të këqijat... është një e ligë, e cila i asgjëson të mirat.

Vetëmashtrimi, glorifikimi i mendimit që jep, siguria nga dënimi i Allahut, mospërfitimi nga këshillimi dhe konsultimi, mbyllja e rrugëve që të çojnë drejt urtësisë, vetmia dhe izolimi janë vetëm disa nga pasojat e vetëpëlqimit. Vetëpëlqimit mundemi t'i shmangemi nëse i dimë shkaqet e tij. Injoranca është shkak i parë i vetëpëlqimit, sepse ky nënkupton injorancën më të madhe, e cila është mosnjohja e Krijuesit dhe Dhuruesit. Gazaliu përmend edhe këto shkaqe të vetëpëlqimit:

Injoranca, mungesa e vetëpërmbajtjes, mungesa e devotshmërisë, dobësia e vetëdijes për mbikëqyrjen e Allahut, qëllimi i keq, numri i vogël i këshilluesve dhe numri i madh i lavdëruesve, mashtrimi pas bukurive të kësaj dynjaje, pasimi i epshit, shpirti që anon nga e keqja, mungesa e meditimit, falënderimit dhe e lartësimit të Allahut, mospërfitimi nga ajetet e Kuranit dhe hadithet e të Dërguarit, siguria nga dënimi i Allahut dhe mbështetja tek falja dhe mëshira e Allahut. Po të mendonte qoftë edhe pakëz robi, ai do të kuptonte se dhuruesi i çdo të mire është Allahu. Duke i pasur parasysh këto shkaqe dhe duke u munduar t'u shmangemi atyre me ndihmën e Allahut do ta fitojmë vetëpëlqimin.

Me mbështetjen e Allahut realizohen qëllimet. ■



MOSSHPEJTIMI NË DHËNIEN E FETVAVE

Kasim b. Muhamed b. Ebu Bekër është pyetur për një gjë dhe ka thënë: Nuk e di mirë (këtë çështje). Pyetësi i thotë: Unë kam ardhur te ti dhe nuk di tjetër njeri përpos teje. Kasimi i ka thënë: Po më shikon me mjekër të gjatë dhe me shumë njerëz përreth meje, por unë vallahi nuk e di mirë këtë

OMER SULEJMAN EL ESHKAR

Sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta, e kanë shqyrtuar ixhtihadin¹ e tyre dhe nuk kanë nxituar për të shqiptuar ndonjë dispozitë pa e shqyrtuar mirë atë.

Abdullah b. Mesudi u pyet për burrin që është martuar me një grua e pastaj ka vdekur, por ai nuk është veçuar me të (nuk ka hyrë dhëndër), si dhe nuk i ka caktuar asaj mehrin.

Një muaj e kanë diskutuar këtë çështje tek ai disa herë. Më pas ai ka thënë: unë në lidhje me këtë çështje po them: Asaj gruajë i takon mehri, ashtu siç e kanë pasur gratë e

mëparshme të tij, pa shtesë dhe pa mangësi. Po ashtu i takon trashëgimia dhe duhet të kryejë idetin. Nëse e kam goditur është prej Allahut, e nëse është gabim, atëherë ajo është prej meje dhe prej shejtanit. Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të pastër.

Disa njerëz nga fisi Eshxha ndërmjet të cilëve ishin Xherahu dhe Ebu Sinani reagan. Ata thanë: O Ibën Mesud, ne dëshmojmë se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selam ka gjykuar tek ne për Burun, bijën e Vashikut, e burri i saj është Hilal b. Murre Eshxhai ashtu siç ke gjykuar ti. Abdulla ibn Mesudi u gëzua shumë, sepse gjykimi i tij u përputh me gjykimin e të Dërguarit të Allahut salallahu

¹ Ixhtihad quhet përpjekja e një dijetari me ndihmën e shkencave fetare për të nxjerrë një dispozitë të caktuar.

“Me të vërtetë ai që u jep fetva njerëzve për çdo gjë që pyetet, është i çmendur...”

alejhi ue selem.

Kjo metodologji që ka ndjekur Ibën Mesudi është metodologjia e të gjithë sahabëve. Ibën Kajimi rahimehullah ka thënë: Selefët nga sahabët dhe tabiinët e urrenin shpejtimin në fetva dhe secili prej tyre dëshironte që atë përgjegjësi ta marri tjetri. Kur e shihnin se nuk ka ku të shkojë, atëherë kontribuonin me zell në shqyrtimin e dispozitës përkatëse duke u bazuar në Kuran dhe Sunet, në fjalët e kalifëve të drejtë e pastaj jepnin fetva.

Abdulla b. Mubareku ka thënë: Sufjani na ka treguar nga Ata b. Saibi, nga Abdurrahman b. Ebu Lejla i cili ka thënë: Kam takuar njëqind e njëzetë veta nga sahabët e të Dërguarit salallahu alejhi ue selem, sa më kujtohet ka thënë se çdonjëri prej tyre që kishte për të treguar hadithe, dëshironte që atë ta bëjë ndonjë tjetër dhe po ashtu edhe pse çdonjëri prej tyre ishte kompetent për të dhënë fetva, megjithatë dëshironte që fetvanë ta jepte tjetri.

Imam Ahmedi ka thënë: Xheriri na ka treguar nga Ata b. Saibi, nga Abdurrahman b. Ebi Lejla se ka thënë: I kam takuar njëqind e njëzet veta nga ensarët dhe nga sahabët e të Dërguarit të Allahut salallahu alejhi ue selem, që kur pyeteshin për ndonjë çështje, dëshironin që tjetri ta marri për sipër dhe po ashtu kur duhej të tregohej ndonjë hadith, dëshironte që atë gjë ta bënte tjetri.

Imam Maliku ka thënë nga Jahja b. Saidi, se Ibën Abasi ka thënë: Me të vërtetë ai që u jep fetva njerëzve për çdo gjë që pyetet, është i çmendur.

Muhamed b. Axhlani ka thënë: Kur ta

neglizhojë dietari fjalën “nuk e di” është goditur për vdekje.

Kasim b. Muhamed b. Ebu Bekër është pyetur për një gjë dhe ka thënë: Nuk e di mirë (këtë çështje). Pyetësi i thotë: Unë kam ardhur te ti dhe nuk di tjetër njeri përpos teje. Kasimi i ka thënë: Po më shikon me mjekër të gjatë dhe me shumë njerëz përreth meje, por unë vallahi nuk e di mirë këtë. Një plak nga kurejshët, që kishte qenë ulur pranë tij tha: O biri i vëllait tim, mere parasysht (d.m.th., përgjigju), se unë vallahi në çdo mexhlis të kam parë më shpirtmadh se sot. Kasimi i tha: Vallahi të më prehet gjuha do të ishte më e dashur për mua se sa të flas për diçka që nuk kam dituri.

Sufjan b. Ujejne dhe Sehnun b. Saidi autor i Mudevenes” kanë thënë: Më i guximshmi mes njerëzve për fetva është ai që ka më pak dituri.

Një njeri e ka pyetur Malik b. Enesin ditë me radhë për një gjë dhe më në fund i ka thënë: Unë flas për një gjë që mendoj se është hair, por këtë çështjen tënde nuk e di mirë.

Hejthem b. Xhemil ka thënë: E kam parë Malikun që është pyetur për dyzet e tetë çështje nga të cilat për tridhjetë e dy ka thënë nuk i di.

Ndoshta mund të jetë pyetur imam Maliku për pesëdhjetë çështje dhe ai nuk është përgjigjur në asnjërën nga ato. Është pyetur për një çështje dhe ka thënë: Nuk e di. I kanë thënë atij: Kjo është çështje e lehtë, e kollajshme. Ai është zemëruar dhe ka thënë: Nuk ka në dituri gjë të lehtë. A nuk e ke dëgjuar fjalën e Allahut **“Ne do të shpallim ty fjalë të rëndë (të madhe)”**. (Muzzemil 5) dituria, e gjitha është e rëndë e veçanërisht ajo për të cilën do të pyetesh Ditën e Kijametit.

Abdullahu i biri i imam Ahmedit ka thënë në pyetjet që i kanë parashtruar: E kam dëgjuar babanë tim kur ka thënë: Abdurrahman b. Mehdiu ka thënë: Një njeri

nga banorët e Marokut (perëndimit të shtetit islam) e ka pyetur Malik b. Enesin për një pyetje, ai u përgjigj me: Nuk e di. Ai tha: O Ebu Abdullah, po thua nuk e di?! Tha: Po dhe thuaji të tjerëve pas teje, se unë nuk e di.

Kështu e kishin kuptuar fikhun gjenerata e parë, me këtë metodologji, se kjo dituri i ka bazat hyjnore, dhe se fetvaja pa dituri llogaritet si thënie kundër Allahut, dhe se është nga krimet e mëdha për të cilat na e kanë tërhequr vëmendjen rreptësisht tekstet, siç mund ta gjesh në thënien e Allahut: ***“Thuaj: “Zoti im i ndaloj vetëm të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta ose të fshehta, ndaloj mëkatin, ndaloj shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloj t’i vishni Allahut shok pa pasur për të kurrfarë argumenti, dhe ndaloj të thoni për Allahun atë që nuk e dini se është e vërtetë.”*** Araf 33

Po ashtu edhe në Ajetin: ***“Mos i thoni asaj rrenës së gjuhëve tuaja: “Kjo është hallall e kjo është haram” e të shpifni ndaj Allahut rrenë. Vërtet, ata që shpifin rrenë ndaj Allahut, nuk kanë shpëtim.”*** Nahël 116

Këshillimi i shpeshtë me dijetarët dhe fukahatë

Kalifët këshilloheshin me sahabët për çështje, të cilat nuk gjenin dispozita në Librin e Allahut dhe në Sunetin e të Dërguarit. Librat e Sunetit na e kanë përcjellë dialogun që është zhvilluar mes Omer b. Hatabit, Ebu Bekrit dhe Zejd b. Thabitit – radijallahu anhum - në lidhje me tubimin e Kuranit.

Është zhvilluar debat mes sahabëve rreth luftimit të murtedëve, të cilët refuzuan ta japin zekatin, por e shprehnin shehadetin. Në atë debat u morën vesh se është e detyrueshme për t’i luftuar.

Omer b. Hatabi ka pasur një grup nga sahabët më të vjetër, që i mblidhte dhe këshillohej për çështje të tij. Në mesin e tyre kishte edhe Ibën Abasin, megjithëse ishte shumë i ri. Shumë njerëz u ankuan se ai po i jep prioritet nga të rinjtë atij ndaj tjerëve që

ishin moshatarët e tij. Omeri i tuboi dhe u bëri një pyetje, por nuk u përgjigj saktë askush, përveç Ibën Abasit. Me këtë kishte si qëllim t’iu tregojë për diturinë dhe fikhun e tij. Ai donte të tregonte se ai e meriton të jetë nga anëtarët Këshillit. (Ehlu Shura).

Nga çështjet për të cilat është këshilluar Omer b. Hatabi radijallahu anhu ishte edhe për tokat që u çliruan nga muslimanët, a u ndahen luftëtarëve, apo mbeten vakëf i Bejtul-Malit (Arka Shtetërore)?

Buhariu, Allahu e mëshiroftë, në Sahihun e tij ka thënë: pas Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, prijësit këshilloheshin me dijetarët në gjërat mubah për të marrë atë që është më e lehtë. Kur atë çështje e qartësonte Kurani dhe Suneti, ata nuk kalonin në tjetër, por e pasonin Pejgamberin salallahu alejhi ue selem. Ebu Bekri ishte i mendimit t’i luftojë ata që e refuzuan ta japin zekatin. Omeri radijallahu anhu i tha: Si do t’i luftosh kur Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë: ***“Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit derisa të thonë: La ilahe il-lallah (s’ka të adhuruar përpos Allahut), e kur të thonë La ilahe il-lallah, do t’ua mbrojmë gjakun (jetën) dhe pasurinë, përpos me hakun e vet, dhe llogarinë do ta kenë tek Allahu.”***

Ebu Bekri ka thënë: Vallahi do t’i luftoj ata që ndajnë atë që ka bashkuar i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, e pastaj në këtë veprim e pasoi edhe Omeri. Ebu Bekri nuk u ndal të këshillohej, meqë ai pati gjykimin e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, në lidhje me ata që dallojnë mes namazit dhe zekatit dhe dëshirojnë të ndryshojnë fenë dhe dispozitat e saj. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë: ***“Kush e ndërton fenë e vet, mbyteni!”***

Pejgamberi alejhi selam është këshilluar me sahabët e tij në betejën e Uhudit për dalje, ose qëndrim. Ata ishin të mendimit që të dali me ata. Ai pasi e veshi mburojën dhe ia mësyu, ata i thanë: Rri, mos dil! Ai nuk e mori

parasysh thënien e tyre pasi ishte nisur të dalë dhe ka thënë: *"Nuk bën për një peygamber që të veshi parzmoren e pastaj ta lejë derisa të gjykojë Allahu"*.

Ai është këshilluar me Aliun dhe Usamen radijallahu anhuma në ndodhinë e shpifjes me Aishen. Ai i dëgjoi të dy derisa zbritën ajetet për këtë ndodhi dhe pastaj i kamxhikoi që të dy shpifësit dhe nuk u kthye te mospajtimi i atyre të dyve, por gjyko me atë që e urdhëroi Allahu.

Ebu Bekri dhe Omeri pas tij i kanë detyruar fukahatë nga sahabët të qëndrojnë në Medine, që të jetë më i lehtë këshillimi me ata për çështje të vështira. Ebu Bekër Sidikut i është paraqitur një çështje për të cilën nuk dinte ndonjë dispozitë të sheriatit. Ai i pyeti sahabët e Pejgamberit alejhi selam dhe në mesin e tyre gjen dituri në lidhje me atë çështje.

Është pyetur Ebu Bekri radijallahu anhu për trashëgiminë e gjyshes dhe ka thënë: Nuk ke gjë në Librin e Allahut dhe nuk di të ketë gjë për ty në Sunetin e të Dërguarit të Allahut, mirëpo do t'i pyes të tjerët. Kur i pyeti ata, Mugire b. Shube dhe Muhamed b. Mesleme i treguan se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem i ka dhënë një të gjashtë.

Prandaj udhëheqësit e kanë detyrim që të kenë një grup dijetarësh, fukaha, mendimtarë dhe largpamës që të këshillohen për çështjet dhe problemet, ashtu siç kanë bërë kalifët më parë. Po ashtu e kanë për detyrim edhe dijetarët që të këshillohen ndërmjet tyre që të qartësohen më mirë çështjet, të qartësohen më tepër argumentet dhe faktet tek të cilat mundet të mbështetemi për njohjen e hakut. ■

Marrë nga libri "Fikhul ihtilaf"
Përshtati Ali SHABAN

TË MËSOSH PËR ZOTIN - MËSIMI MË I VLEFSHËM

Allahu subhanehu ue teala thotë: "Përqendroje vetveten sinqerisht në fe", e i larguar prej çdo të kote, feja e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim nga natyrshmëria e krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë."

DR. MUHAMED B. MUSA EN NASËR

1. Vlëra e diturisë është sipas vlerës së asaj që mësohet, e Allahu është më i vlefshmi që mësohet. Pra, dituria e besimit, teuhidit është dituria më e vlefshme dhe më me meritë që duhet të kërkohet. Imam Ibën Rexheb Hanbeliu thotë: Dituria e dobishme është ajo që e njofton robin me Zotin vet, i tregon për Të që ta njohë dhe ta njësojë, ta ndiejë dhe të turpërohet prej Tij, derisa ta adhurojë sikur e sheh Atë, i Lartmadhëruar goftë Allahu.

2. Akideja (besimi) dhe Teuhidi, që të dyja janë qëllimi i krijimit të xhinëve dhe njerëzve.

Allahu I Madhërishëm thotë: ***“Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit për tjetër përveçse të më adhurojnë, nuk kërkoj prej tyre furnizim dhe as të më ushqejnë.”***

Fraza ***“..të më adhurojnë”*** sipas mendimit të drejtë të komentuesve është teuhidi d.m.th.: ***“të më njësojnë”***.

3. Është çelësi i thirrjes i të gjithë të dërguarve dhe ajo është qëllimi për të cilin janë dërguar Pejgamberët përgëzues e qortues.

Allahu subhanehu ue teala në disa ajete thotë: ***“Ne kemi dërguar në çdo popull të dërguar që t’ju thonë adhuroni vetëm Allahun e largohuni nga tagutët (adhurimi i dikujt tjetër).”***

“Kur kemi dërguar ndonjë pejgamber para teje i kemi shpallur atij, se nuk meriton të adhurohet askush pos Allahut, prandaj më adhuroni Mua”.

“E ti, pra, pyeti ata të dërguarit që i dërguam para teje, a kemi lejuar që në vend të Allahut të adhurohen zota të tjerë?”

Ja pra, i Dërguari i Allahut, mik dhe i zgjedhur i Tij, trembëdhjetë vite me radhë pas dërgimit të tij qëndroi duke thirrur në përmirësimin e besimit dhe pastrimin e saj nga ajo që ia kishin veshur nga shirku, idhujtaria e injoranca, e gjithashtu vazhdoi edhe pas emigrimit të tij në Medinë, me pastrimin e besimit dhe qortimin nga ato veprime që e kundërshtojnë Teuhidin. Ndërsa para tij të gjithë të dërguarit e Allahut thanë të njëjtën gjë: ***“O populli im, adhuroni vetëm Allahun, ju nuk keni të adhuroni tjetër që meriton adhurimin përpos Tij”.***

Jusufi, alejhi selam, që u sprovua në burg thërriste në Teuhid dhe ua vonoi përgjigjen dy shokëve të tij, që e kishin pyetur, edhe pse ata mezi po prisnin që Jusufi t’u përgjigjej, por ai i thirri në Teuhid dhe u tha: ***“Unë kam braktisur***



fenë e një populli që nuk e beson Allahun, as botën tjetër, e ata ishin jobsimtarë. Unë ndoqa fenë e prindërve të mi: Ibrahimit, Is’hakut, Jakubit. Neve nuk na takoi t’i përshkruajmë kurrë një send shok Allahut. Ky (besim i drejtë) është dhuratë e madhe nga Allahu ndaj nesh dhe ndaj njerëzve, por shumica e njerëzve nuk falënderojnë. O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm apo Allahu, i vetmi ngadhënjimtarë? “Ata që ju adhuroni përveç Allahut, nuk janë tjetër vetëm se emra që pagëzuar ju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi (në çështje të adhurimit) nuk i takon askujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të

mos adhuroni tjetër kënd por vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë”.

Dijetari Islam Ibën Tejmije Allahu e mëshiroftë ka thënë: “Kjo në Kuran përmendet në shumë vende: Allahu qartëson se të gjithë pejgamberët kanë urdhëruar në Teuhid - njësimin e Allahut, që të adhurohet vetëm Allahu i pashoq, dhe kanë ndaluar nga adhurimi i dikujt tjetër prej krijesave, apo marrjen për zot; gjithashtu Allahu tregon se fatlumët janë besimtarët, ata që e njësojnë Allahun, ndërsa ata që i bëjnë shirk (shok) Allahut ata janë më fatkëqijtë, këtë Allahu e ka përmendur nga të gjithë të dërguarit, dhe ka qartësuar se ata që nuk besojnë pejgamberët janë mushrikë (idhujtarë).

4. Për shkak të saj Allahu ka zbritur librat, Allahu i Madhërishëm thotë: **“Me urdhrin e Tij ai zbret engjëjt me shpallje atij që Ai dëshiron nga robërit e vet** (duke u thënë) **t’ua tërhiqni vërejtjen se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Meje, pra të më keni frikë.”**

5. Allahu krijoi xhenetin dhe zjarrin për shkak të besimit. Kush e kundërshton Teuhidin do ta kapi Zjarri sipas kundërshtimit të tij, ndërsa kush e mohon thelbin e saj do të jetë në Zjarr përgjithmonë, Allahu na ruajt.

6. Për shkak të saj Allahu e krijoi këtë botë, dhe e zbriti Ademin dhe gruan e tij nga xheneti në këtë botë, që të jetojnë ai dhe pasardhësit e tij e ta ndërtojnë këtë botë, duke e njësuar Allahun dhe duke iu nënshtruar Atij.

7. Për shkak të saj është bërë e ligjshme lufta në rrugën e Allahut. Allahu thotë: **“Luftojini ata (idhujtarët) derisa të zhduket sprova e tyre dhe derisa të**

aplikohet feja vetëm për Allahun...”.”

Imami i njohur dhe komentuesi i Kuranit Muhamed b. Xherir Taberiu, Allahu e mëshiroftë, kur komenton fjalinë **“të zhduket sprova”** thotë: të zhduket shirku-idhujtaria, e të mos adhurohet askush tjetër pos Allahut të pashoq, e kështu tërhiqet ndaj robërve të Allahut sprova e tyre, dhe **“të aplikohet feja vetëm për Allahun”** thotë: derisa të jenë nënshtrimi dhe adhurimi të sinqertë për Allahun, jo për dikë tjetër.¹

8. Akideja-Teuhidi është detyrimi i parë i robërve. Allahu subhanehu ue teala thotë: **“dhe dije se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë pos Allahut.”** Imam Buhariu Allahu e mëshiroftë thotë: “Ka filluar me diturinë para fjalës dhe veprës.”

Na përcillet nga Ibën Abasi Allahu qoftë i kënaqur me të, se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, kur e dërgoi Muadhin në Jemen i tha: **“Ti me të vërtetë po shkon te një popull që janë Ithtarë të Librit (krishterë e hebrenj), gjëja e parë që do t’u kumtosh le të jetë dëshmia, se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë pos Allahut...”**² sipas një transmetimi tjetër tha **“thirri ata derisa ta njësojnë Allahun e Lartë.”**

9. Akideja - Teuhidi është natyrshmëria në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. Allahu subhanehu ue teala thotë: **“Përqendroje vetveten sinqerisht në fe’, e i larguar prej çdo të kote, feja e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s’ka ndryshim nga natyrshmëria e krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”**

I Dërguari salAllahu alejhi ue selem ka

¹ Buhariu (1458), Muslimi (19), (31)

² Muslimi (93), (153), Ahmedi (3\325) nga Xhabiri.

thënë: “Çdo fëmijë lind në natyrshmëri, e prindërit e tij e bëjnë jehudi, ose të krishterë, ose zjarrputist.”

10. Veprat pranohen me besim të pastër. Allahu i Madhërishëm në disa ajete thotë: **“Kush bën një vepër të mirë, goftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë** (në këtë botë), (e në botën tjetër) **do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”**

“Me të vërtetë ty të është shpallur e edhe atyre para teje: nëse i bën shok (Allahut), veprat e tua janë të asgjësuar dhe ti do të jesh prej të humburve.”

“...e sikur t’i përshkruajnë shok Zotit kishte për t’ju shkuar huq ajo që kanë vepruar.”

11. Vendi i pasuesve të besimit së pastër është xheneti. Allahu i Madhërishëm thotë: **“...ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar atij xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.”**

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thotë: **“Kush e takon Allahun duke mos i bërë shok Atij askënd do të hyjë në xhenet, ndërsa kush e takon Atë duke i bërë shok do të hyjë në Zjarr.”**³

I Dërguari i Allahut gjithashtu thotë: **“Kush dëshmon se nuk ka të adhuruar me të drejtë pos Allahut, të pashoq, Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, e Isai është rob i Allahut dhe i dërguar i Tij dhe është si rezultat i fjalës së Allahut bëhu, që i është drejtuar Merjemes, e është frymë (shpirt) nga Allahu, dhe se xheneti është i vërtetë, e zjarri i vërtetë, do ta fus Allahu në xhenet nga secila derë**

“... Akideja mbjell te pronari i saj forcën dhe qëndrueshmërinë para sprovave, vështirësive, mundimeve e problemeve...”

prej tetë dyerve të tij.”⁴, në një trasmetim të Muslimit thotë: **“do ta fus Allahu atë në xhenet edhe nëse ka pak vepra.”**

Gjithashtu ai thotë: **“Allahu ia ka ndaluar zjarrin atij që thotë “la ilahe ilallah”, duke e thënë këtë vetëm për hir të Allahut.”**⁵

12. Akideja - besimi është shkak i faljes së të gjitha mëkateve. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Allahu me të vërtetë nuk e fal (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i fal kujt të do.”**

Muhamedi salAllahu alejhi ue selem thotë: **“Allahu i Madhëruar ka thënë: O biri Ademit, sikur të më vish me mëkate sa toka dhe më takon Mua pa më shoqëruar askënd, do të vij me po aq falje.”**⁶

13. Allahu e ka bërë teuhidin - njësimin e Tij prej të drejtave më të mëdha, ndërsa e ka bërë shirkun - idhujtarinë prej mëkateve më të mëdha. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij...”**

Gjithashtu thotë: **“Nëse largoheni prej mëkateve të mëdha, të cilat u janë të ndaluara, Ne ju shlyejmë mëkatet e vogla**

³ Muslimi (93), (153), Ahmedi (3\325) nga Xhabiri.

⁴ Buhariu (3435), Muslimi (28), nga Ubadete b. Samiti radijallahu anhu.

⁵ Buhariu (425), (6938) dhe kjo frazë është prej tij, Muslimi (33) nga Utban b. Maliku radijallahu anhu.

⁶ Tirmidhiu (3534), Ahmedi (5\154) Albani e ka saktësuar në “Es Silsiletus sahiha” (128).

dhe ju fusim në një vend të ndershëm.”

Na përcillet nga Muadh b. Xhebeli radijallahu anhu, të ketë thënë: *“Isha mbrapa Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem i hipur në gomar, kur Resulullahi më tha: “O Muadh, a e di se cila është e drejta e Allahut për robërit dhe e drejta e robërve për Allahun? Thashë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. Më tha: “E drejta e Allahut për robërit është që ta adhurojnë Atë dhe mos t’i bëjnë shok, ndërsa e drejta e robërve për Allahun është të mos i dënojnë ata që nuk i bëjnë shok.”*”⁷

14. Akideja - besimi është shkaku më i madh për largimin e sprovave të kësaj bote dhe të botës tjetër: Allahu i Madhërishtëm thotë: *“E atyre të cilëve u priu e mbara nga ana Jonë do të jenë larg tij (xhehenemit). Ata nuk do të dëgjojnë as zhurmën e tij dhe ata do të jenë përgjithmonë të kënaqur me atë që e dëshirojnë vetë. Ata nuk do t’i shqetësojë ajo frika e madhe (e fryrjes së Surit), dhe do t’i presin engjëjt (duke i uruar): “Kjo është dita juaj që u premtohet”.*

Gjithashtu Allahu thotë: *“Kush bën një vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), (e në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre”.*

15. Akideja - teuhidi është prej shkaqeve më të mëdha që të fitohet ndërmjetësimi i Resulullahut salallahu alejhi ue selem. Përcillet nga Ebu Hurejra radijallahu anhu se ka thënë: I kam thënë të Dërguarit të Allahut: Kush është më meritori për shefatin (ndërmjetësimin) tënd? Më ka thënë: *“Kush thotë ‘la ilahe ilallah’ (nuk ka të adhuroar me meritë*

përveç Allahut) me sinqeritet nga thellësia e zemrës.”⁸

16. Atyre që kanë akide të pastër Allahu ua ka garantuar ndihmën, udhëzimin, sigurinë dhe sundimin në këtë botë. Allahu i Madhërishtëm thotë: *“Atyre nga mesi i juaj që besuan dhe bënë vepra të mira Allahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu siç i bëri zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.”*

Gjithashtu Allahu thotë: *“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me idhujtari (shirk), atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë.”*

17. Akideja mbjell te pronari i saj forcën dhe qëndrueshmërinë para sprovave, vështirësive, mundimeve e problemeve, duke qenë kështu pasues i pejgamberëve, të cilët e sollën këtë besim nga Allahu dhe të cilët ishin të durueshëm në rrugën e Allahun ndaj asaj që hasnin.

18. I pastron zemrat e besimtarëve nga shkaqet e ndarjes dhe përçarjes, me të cilat janë sprovuar pasuesit e epsheve dhe risive (bidateve).

19. Besimi - teuhidi bën që robi të jetë i pavarur dhe i lirë e të mos i nënshtrohet dhe përulet askujt nga krijesat. ■

***Përktheu: Fidan Xhelili
Jordani***

⁷ Buhariu (2856), (7373), Muslimi (30), (49).

⁸ Buhariu (99), (6570).



PARAJA ELEKTRONIKE

KARTELAT BANKARE (1/2)

Për të krijuar një ide më të qartë mbi këto shërbime që tani pothuajse janë bërë domosdoshmëri për secilin do të sqarojmë më shumë, duke treguar llojet e tyre, mënyrat e përdorimit, përparësitë, gjithashtu edhe qëndrimin e Jurisprudencës Islame rreth këtyre llojeve.

SHKRUAN: ALAUDIN ABAZI

Sistemet bankare bashkëkohore vazhdojnë të fusin ndryshime të tërësishme, në lidhje me paranë dhe zhvillimin e bizneseve. Ndër këto ndryshime është edhe mënjanimi i përdorimit të parave të gatshme (kesh-cash), gjatë tregtive të ndryshme duke e zëvendësuar atë me paranë elektronike, e cila i vihet në dispozicion klientit 24 orë në ditë dhe kudo që ka nevojë.

Për të krijuar një ide më të qartë mbi këto shërbime që tani pothuajse janë bërë domosdoshmëri për secilin do të sqarojmë më shumë, duke treguar llojet e tyre, mënyrat e përdorimit, përparësitë, gjithashtu edhe qëndrimin e Jurisprudencës Islame rreth këtyre llojeve.

Çfarë janë kartelat bankare:

Kartelat bankare në gjuhën arabe quhen: “**Bitakat el ʿitiman**” dhe ato janë kartela metalike apo plastike, që i nxjerrin në

përdorim bankat komerciale ose institucionet financiare dhe shërbejnë si pajisje me të cilën mund të tërheqim para ose të bëjmë pagesa të ndryshme. Me fjalë të tjera zotëruesi ka mundësi që me këtë kartelë të blejë ose të sigurojë para të gatshme nga institucioni, i cili e lëshon atë kartelë. Në të shënohet emri i bartësit, data e lëshimit, data e skadimit të afatit dhe numri i kartelës. Ajo përmban edhe fjalëkalimin me anë të të cilit klienti i qaset llogarisë së vet bankare dhe ky nuk shënohet në kartelë e këtë nuk e di askush përveç pronarit të saj.¹

Asambleja Ndërkombëtare e Fikhut Islam i përkufizon kartelat bankare si vijon: **“Dokument që e lëshon autoriteti kompetent (banka) për një person fizik apo juridik², bazuar mbi një marrëveshje mes tyre. Kjo (marrëveshje) i jep mundësi zotëruesit të shit-blejë dhe të kryej shërbime të tjera me atë që e merr në konsideratë këtë dokument (tregtari), pa e paguar çmimin në çast, për shkak se burimi (banka) e merr përsipër pagesën.”**³

2- Cili është autoriteti kompetent për lëshimin e këtyre kartelave

Kartelat bankare lëshohen nga bankat të cilat kanë licencë prej institucioneve financiare ndërkombëtare të njohura dhe ato janë pronarët legjitimë të këtyre kartelave. Organizatat më të njohura janë:

- AMERICAN EXPRESS
- VISA
- MASTER CARD
- EURO CARD
- DINERS CLUB etj.

3- Llojet e kartelave bankare

Në kohën tonë kemi disa lloje kartelash bankare dhe kemi vazhdimisht risi në lidhje

me to varësisht prej formave dhe kreativitetit, që ofron konkurrenca e bankave. Nëse fillojmë shtjellimin e të gjitha këtyre llojeve një nga një, atëherë do të nevojitet një zgjerim ndoshta edhe i bezdisshëm për lexuesin, prandaj do të bëjmë një ndarje të përgjithshme të këtyre llojeve duke i klasifikuar vetëm në dy sosh, pastaj do ta shtjellojmë secilin lloj në vete.

Këto dy lloje janë:

Kartela me Mbulesë - Kartelat e Debitit

Kartela pa Mbulesë - Kartelat e Kreditit

Kartelat me Mbulesë - Kartelat e Debitit

Kartelat e debitit në gjuhën arabe quhen “Bitaketu Mugat-ta”, “Kartela me Mbulesë”, meqë mbulohet me llogarinë e klientit, që ai ka në bankë. Ndërsa në rajonin tonë këto kartela quhen edhe “Kartela Këmbimi”.

Kartela e Debitit është kartelë klasike, të cilën banka ia lëshon klientit që ka një llogari bankare tek ajo. Kjo kartelë është e lidhur drejtpërdrejtë me llogarinë rrjedhëse të klientit dhe përmes saj mund të shfrytëzohet të gjitha të hollat, që ai ka në atë llogari. Zotëruesi i kësaj kartele bën tërheqje **kesh** të këtyre të hollave përmes rrjetit të bankomatëve ATM⁴, në shtetin e tij dhe kudo në botë. Ai gjithashtu me këto kartela mund të blejë nëpër dyqane të ndryshme, që do të thotë se këto kartela zëvendësojnë paratë e gatshme duke shmangur kështu rrezikun e humbjes apo vjedhjes. Kjo kartelë jep mundësinë e përdorimit të parave 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, në çfarëdo kohe, në çfarëdo vendi.

Maestro dhe **VISA Electron** janë dy firmat më të njohura botërore të kartelave debit, që

¹ “El Muamelat el Malije el Muasire”, dr. Vehbe Zuhejli, fq. 537; “Fikhul Muamelat el Malijel Muasire”, dr. Sad el Hathlan, f. 150. <http://www.klubikulturor.com/ppoint/kartelat.pps>

² Person juridik konsiderohen ndërmarrjet, firmat tregtare, institucionet shoqërore, etj.

³ Vendimi i Asamblesë Ndërkombëtare të Fikhut Islam, nr. 7/1/ 65.

⁴ Automatic Teller Machine

nënkupton se këto mund t'i përdorim në të gjitha bankomatet në të cilat shohim shenjë e tyre.

Banka regjistron transaksionet e klientëve, të cilat kryhen përmes kësaj karteje, kështu që zotëruesi mund të rishikojë shpenzimet e tij kur të dëshirojë dhe kjo i ofron klientit kontroll të plotë mbi paratë.

1) Dispozita shariatike e Debit Kartelave

Nuk ka ndonjë arsye që të konsiderohet i ndaluar ky lloj kartelash, prandaj dispozita e saj është se lejohet të përdoren ato. Kjo për faktin se zotëruesi i kësaj karteje bën vetëm tërheqjen nga llogaria e tij dhe nuk ka ndonjë kushtëzim, që do ta shpinte atë në kamatë apo në diçka tjetër të ndaluar. Prandaj meqë nuk ka ndonjë paqartësi në mënyrën e funksionimit të këtij lloji karteje dhe nuk ka komplikime, asamblatë shkencore bashkëkohore të fikhut nuk janë marrë me hulumtimin e mëtejshëm të këtij lloji.

2) Disa çështje që kanë të bëjnë me kartelat e debitit

Edhe pse theksuam se institucionet shkencore shariatike nuk i kanë shtjelluar kartelat e debitit, për shkak se klienti me këtë shërbim vetëm i qaset parave, të cilat i ka të depozituara në bankë dhe nuk ka komplikime në përdorimin e kartelave të debitit, megjithëkëtë ekzistojnë disa sqarime që janë bërë nga disa dijetarë bashkëkohorë, që kanë folur për këtë lloj kartelash. Në vazhdim do të përcjellim shtjellimet e këtyre çështjeve.

Çështja e parë: Pagesa e tarifës për shërbime administrative

Zakonisht ky lloj i kartelave lëshohet

falas, por në disa banka bëhet pagesa mujore e shërbimeve administrative, qoftë edhe me një shumë formale, fjala vjen 0.50 euro në muaj. Sidoqoftë, klienti të paguajë një taksë si shpenzim administrativ për llogari të bankës, duke mos e bazuar atë shpenzim me përqindje, por në shpenzimet reale që ka bërë banka për ta lëshuar atë produkt konsiderohet si procedurë e lejuar në Islam.⁵

Çështja e dytë: A lejohet blerja e arit dhe e argjendit me kartelë debitit

Arsyeja se pse ngrihet kjo çështje si problematikë është se ari dhe argjendi janë nga mallrat me të cilat ndodh kamata, nëse shit-blihen me para duke mos i dorëzuar të dy mallrat në të njëjtën kohë. Me fjalë të tjera nëse blihet ari apo argjendi me para, atëherë duhet patjetër që të shkëmbehen ato (ari dhe paratë) në të njëjtin tubim (dorë më dorë). Për këtë nuk lejohet që të shkojmë tek argjendari e të blejmë arin me borxh dhe nëse e blejmë kështu, atëherë kemi rënë në kamatë. Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, thotë: *“Nëse ndryshojnë këto lloje (mallrat e kamatës), atëherë shisni si të doni me kusht që shitblerja të jetë dorë më dorë”*.⁶

Por nëse shkojmë tek argjendari dhe blejmë ar dhe në vend që të paguajmë me para të gatshme i dorëzojmë kartelën bankare të debitit dhe e bëjmë pagesën e shumës së nevojshme me kartelë direkt nga llogaria jonë, a është e lejuar kjo apo jo dhe pagesa në këtë mënyrë, a e nënkupton dorëzimin e parave shitësit apo jo?

Përgjigja është se pagesa me kartelë është njësoj sikur të jetë pagesë me para të gatshme, meqë me këtë proces blerësi ia transferon paratë e nevojshme nga llogaria e tij në llogarinë e shitësit. Prandaj blerja e arit dhe e argjendit me këtë lloj karteje është e

⁵ “Fikhul Beji Vel Istithak Vet-tatbikil Muasir”, dr.Ali Salus, f.826.

⁶ Shënon Muslimi

“Nuk lejohet që të shkojmë tek argjendari e të blejmë arin me borxh dhe nëse e blejmë kështu, atëherë kemi rënë në kamatë...”

lejuar dhe nuk ka kurrfarë pengese⁷.

Çështja e tretë: Tërheqja e parave nga bankomatet, të cilat i takojnë bankave të tjera

Edhe kjo çështje është e rëndësishme të sqarohet, sepse ngrihen pikëpyetje në lidhje me të dhe pagesat shtesë që bëhen gjatë tërheqjes së parave nga bankomatet e bankave të tjera. Shembulli i kësaj është: nëse ne zotërojmë një kartelë nga një bankë e caktuar dhe e përdorim atë në bankomatit e një banke tjetër. Pra, të tërheqim para nga bankomati i bankës tjetër në të cilin nuk kemi xhirollogari. **A lejohet kjo apo jo?**

Dijetarët bashkëkohorë për këtë problem kanë dy mendime: Mendimi i parë është se nuk lejohet dhe mendimi i dytë thotë se lejohet.

Ata që e kanë ndaluar këtë thonë se gjatë tërheqjes së parave nga bankomati i bankës tjetër, bëhet një pagesë prej afërsisht dy eurosh e gjysmë. Pastaj gjatë këtij transaksioni ne marrim hua nga kjo bankë, e cila më vonë e rikthen atë hua nga xhirollogaria jonë në bankën në të cilën i kemi të depozituara paratë tona. P.sh., nëse ne tërheqim 200 euro nga bankomati i ndonjë banke tjetër, atëherë ne në fakt kemi marrë borxh nga ajo bankë. Më vonë ajo bankë e rimerr borxhin që na kishte dhënë

neve, nga banka tek e cila ne e kemi llogarinë tonë, vetëm se në këtë rast ajo nuk rimerr vetëm 200 euro, por i merr 202.5 euro. Prandaj ky transaksion ka përzierje me kamatë dhe është i ndaluar.

Megjithë këto shtjellime, e sakta është se lejohet që të tërheqim para nga bankomatet e bankave të tjera, për shkak se në fakt neve gjatë kësaj tërheqjeje i qasemi llogarisë sonë esenciale drejtpërdrejtë dhe nga ajo i tërheqim paratë. Pra, nuk është e saktë se tërheqim para nga llogaria e bankës tjetër (pra, nuk marrim hua nga banka tjetër që më vonë ajo e rimerr atë hua nga banka jonë). Kurse puna e bankës nga bankomati i së cilës bëjmë tërheqje është se ajo vetëm na e ofron shërbimin e qasjes dhe asgjë tjetër. Prandaj pagesa e 2.5 eurove, të cilën e fiton banka, gjatë këtij transaksioni (nëse tërheqim para nga bankomati i ndonjë banke tjetër), është pagesë e shërbimit dhe e shfrytëzimit të bankomatit. Padyshim se aparatet (ATM) kanë shpenzime të llojeve të ndryshme, sikurse pagesa e qirasë së vendit ku vendosen ato, pagesa e rrymës, shërbimi që i bëhet aparatit dhe mirëmbajtja, sigurimi i linjës telefonike ose linjës së internetit etj. Për të gjitha këto bëhen shpenzime dhe banka ka të drejtë t'i kërkojë ato.

Prandaj nga kjo që u parashtrua më lart kuptuam se nuk ka ndonjë turbullirë apo pengesë në lejimin e tërheqjes së parave nga bankomatet e bankave të tjera dhe lejohet marrja e shumës si tarifë e shpenzimeve administrative⁸.

Çështja e katërt: Mbitërheqja

Nëse i aprovohet klientit që të tërheqë një shumë më të madhe se sa ai zotëron në llogari, kjo është e lejuar për të që të tërheqë,

⁷ “Fikhul Muamelat el Malijel Muasire”, dr. Saad el Hathlan, fq. 151. “El Muamelat el Malije”, dr. Jusuf Shibejli, fq. 109.

⁸ “Fikhul Muamelat el Malijel Muasire”, dr. Saad el Hathlan, fq. 152-155.

por të mos ketë kushtëzime për llogaritje të kamatës gjatë këtij transaksioni, qoftë edhe nëse nuk arrijmë të bëjmë pagesën në afatin e paraparë⁹. Për këtë do të flasim më gjerësisht kur do të shtjellojmë llojin e dytë të kartelave.

B. Kartela pa Mbulesë- Kartelë Krediti

Këtë lloj kartele e ka shqyrtuar Asambleja Ndërkombëtare e Fikhut Islam, e cila buron nga Organizata e Kongresit Islamik, në mbledhjen e saj të dymbëdhjetë në Riad të Arabisë Saudite, më 25 Xhumadel Ahire 1421 H, që përputhet me datën 23 Shtator 2000. Ndërsa ashtu siç e theksuam më lart, llojit të parë (Kartelave të Debitit) nuk i është qasur Asambleja, meqë dispozita rreth saj është e qartë.

Kartela pa mbulesë është: **“Dokument që e lëshon autoriteti kompetent (banka) për një person fizik apo juridik, bazuar mbi një marrëveshje mes tyre. Kjo (marrëveshje) i jep mundësi zotëruesit të shit-blejë dhe të kryejë shërbime të tjera me atë që e merr në konsideratë këtë dokument (tregtari), pa e paguar çmimin në çast, për shkak se burimi (banka) e merr përsipër pagesën. Fillimisht pagesa bëhet nga llogaria e burimit, pastaj shuma kompensohet më vonë nga mbajtësi i kartelës brenda disa afateve të vazhdueshme. Një pjesë e autoriteteve kompetente (bankave) e ngarkojnë me kamatë mbi shumën e llogarisë së papaguar pas një kohe të caktuar nga koha e kërkesës dhe disa të tjera jo.”**¹⁰

Kartelat e kreditit te ne quhen edhe kartela “blej tashti - paguaj më vonë!” dhe më të njohurat janë **Maestro** dhe **Visa Classic**.

Zotëruesit të kësaj kartele i ofrohet shumë e parave borxh nga banka dhe nuk kushtëzohet që klienti të ketë xhironlogari apo para të depozituara në bankë. Me këtë kartelë klienti, mund të blejë nëpër dyqane

me të cilat ka marrëveshje banka dhe pagesën e bën banka në vend të klientit. Ai gjithashtu me këtë lloj kartele mund të tërheqë para (kesh) nga bankomatet, edhe pse nuk ka të depozituar asnjë shumë në bankë. Klienti është i detyruar që borxhin e marrë me këtë kartelë ta kthejë brenda afateve të parapara me këste ose menjëherë. Shumica e bankave e kufizojnë afatin deri në 45 ditë pa interes, por disa edhe më shumë se kaq. Pos blerjeve nëpër dyqane, tërheqjes së parave kudo në botë, këto kartela mund të shfrytëzohen edhe për blerje në internet, rezervime të hoteleve si dhe rent-a-car.

Palët pjesëmarrëse në këtë kartelë

Në kartelat pa mbulesë mund të marrin pjesë këto palë:

Pala e parë: *Institucioni financiar ndërkombëtar, i cili e zotëron licencën e kartelës si: “VISA”, “AMERICAN EXPRESS”, “MASTER CARD” etj.* Ky institucion njëherazi është edhe monitoruesi i kartelave që lëshohen në bazë të marrëveshjeve që i realizon me bankat nëpër të gjitha vendet e botës.

Pala e dytë: Banka, e cila e lëshon në qarkullim kartelën.

Pala e tretë: *Bartësi i saj, pra klienti.*

Pala e katërt: *Tregtari ose pronari i shitores tek i cili blen klienti.*

Pala e pestë: *Është e mundur të hyjë si palë edhe ndonjë bankë tjetër në të cilën është klient tregtari (shitësi), por ka mundësi që edhe mos të ketë palë të pestë, por të dy edhe blerësi edhe tregtari të jenë klientë të së njëjtës bankë.*

Qëndrimi sheriatik në lidhje me kartelat pa mbulesë... ■

(për këtë dhe të tjera me rëndësi do të mësoni në numrin e ardhshëm të revistës)

⁹“El Muamelatel Malijel Muasire”, dr. Vehbe Zuhejli, fq. 540

¹⁰ El Muamelatel Malijel Muasire”, dr. Vehbe Zuhejli, f.537.

MENDIMET QË TË TËRHEQIN MBRAPA?



Sa herë i ke thënë vetes “nuk mundem”, “jo tani”, “ka kaluar koha”, “e pamundur”... e shumë e shumë mendime të ngjashme, që kanë ndikuar të ndalosh ose të dështosh derisa edhe ke humbur përfundimisht shansin, e sigurisht edhe shumë shanse të tjera.

SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetje kërkohet që të jesh i relaksuar dhe pastaj të mendosh thellë. Ka shumë mendime, të cilat të pengojnë nga iniciativa për të ndërmarrë kontrollin e vetes në duart e tua, krijojnë dëshpërim, e dobësojnë entuziazmin, i cili të ndihmon për t’i realizuar planet e tua. Në jetë ke humbur shumë shanse për shkak të disa mendimeve të gabuara dhe të dështuara, ndërsa tani ka ardhur koha për të ndryshuar,

mirëpo si ka mundësi t’i ndryshosh këto mendime nëse nuk ke njohuri rreth tyre?

Në fjalorin e suksesit nuk ekzistojnë këto dy fjalë: “Nëse” dhe “por”. Fjala ‘nëse’ nënkupton shtyrjen, zvarritjen, vonesën e përtacinë, si dhe pritjen e mundësisë gjersa të të vijë dhe të trokasë në derën tënde në vend të kërkimit të saj. Ndërsa ‘por’ do të thotë shndërrimi i çdo shansi në vështirësi, problem dhe në të pamundur, e jo trajtim i çdo problemi si mundësi për të mësuar dhe përfituar.

Sa herë i ke thënë vetes “nuk mundem”,

“jo tani”, “ka kaluar koha”, “e pamundur”... e shumë e shumë mendime të ngjashme, që kanë ndikuar të ndalosh ose të dështosh derisa edhe ke humbur përfundimisht shansin, e sigurisht edhe shumë shanse të tjera.

Botëkuptime të tilla nuk duhet të kenë vend në mendjen tënde, dhe duhet t’i flakësh ato me shpejtësi, sepse shumohen sikurse viruset, pastaj ato ta mbizotërojnë mendjen tënde dhe për pasojë ato ta degjenerojnë dhe në fund e prishin atë.

Ndjenja se je bërë i moshuar

Janë të shpeshta deklaratimet që dëgjojmë si: “Tashmë jam i moshuar për... t’u shkolluar, më ka ikur treni...” etj.

Kam takuar shumë njerëz të moshave, gjinive dhe niveleve të ndryshme shoqërore, nuk e teproj nëse them se mosha ka qenë faktori kryesor me të cilin arsyetoheshin ata, të cilët ikin nga përgjegjësia ose vonojnë procesin e ndryshimit nga e mira. Shumica prej tyre thonë: “Mosha ime nuk është e duhur për të bërë këtë...” apo “Jam i vjetër dhe jo i përshtatshëm të merrem me këtë punë...”.

Nuk ka gjë që e dekurajon njeriun, e shuan entuziazmin dhe ëndrrat e tij, sesa hedhja e përgjegjësisë në një pjesë të jetës në të cilën nuk ke kurrfarë kompetence, ashtu si çështja e moshës, sepse kjo e detyron njeriun të shkojë në pension të hershëm, duke u bërë njeri i ngeshëm dhe i padobishëm, që ecën në drejtim të dëshpërimit, humbjes së lumturisë në jetë dhe ndjenjës së depresionit. Mirëpo, a ka mundësi të ndalosh shkatërrimin e vetes nga kjo metodë?

Përgjigjja është po, porse lipset punë dhe jo fjalë. Nëse e vëren se je duke e përdorur këtë hile shkatërruese, të moshës, pyete veten menjëherë “përse jo”, në vend të dorëzimit para kësaj dredhie të kotë. Fillu

“...Në fjalorin e suksesit nuk ekzistojnë këto dy fjalë: “Nëse” dhe “por”...”

menjëherë të mendosh për mënyrën e punës, të cilën dëshiron ta kryesh dhe ta vendosësh në pozicionin e realizimit, edhe në këtë moshë.

Ti nuk je përgjegjës ndaj rezultateve, sepse suksesi është në Dorën e Allahut, mirëpo prej teje kërkohet vetëm të veprosh drejtë, me qëllim që të jesh pjesë e ajetit kuranor: **“Ne nuk do ta humbim shpërblimin për atë që punon drejtë.”**

Nuk mundem!

Po, mundesh. Atë që njerëzit si ti e kanë realizuar, me lejen e Zotit mund ta realizosh edhe ti. Dita për të gjithë zgjat 24 orë, atëherë çfarë të mungon?

E tërë ajo që të mungon është ti thuash vetes: “Po, mundem”. Me këtë nuk kemi si qëllim që ta mashtrosh veten, por ta shohësh realitetin ashtu siç është dhe të bindesh se me të vërtetë ti zotëron aftësitë e duhura. I tërë synimi është se ti ke zgjedhur në të kaluarën që të mos i aktivizosh fare këto aftësi dhe kapacitete, ndërsa tani shpresoj se ke vendosur që të veprosh diçka krejt ndryshe.

Kur të vendosësh, do të arrish!

Ky është kuptimi i vullnetit.

Një fjalë e urtë popullore thotë: “E ka pyetur e mundura të pamundurën, ku banon? Është përgjigjur: në fantazitë e iluzionistëve (të paaftëve).” E vërtetë, sepse vetëm fantazuesit e kotë janë ata që e shohin të pamundurën, ndërsa ata që zotërojnë vullnet të fortë i hulumtojnë vazhdimisht të gjitha rrugët për t’i zgjidhur problemet dhe për t’i larguar barrierat.

Allahu e mëshiroftë Abas Akadin, i cili tha: “Vullneti është si shpata, atë e topitë neglizhenca, ndërsa e mprehë goditja dhe beteja.”

Ai që nuk e shfrytëzon vullnetin e tij dhe i dorëzohet përtacisë e plogështisë e humb fuqinë dhe potencialin për të lëvizur.

Ti mund ta klasifikosh veten me dëshirë në kolonën e dështakëve apo të suksesshmëve. Dallimi në mes atij që është i suksesshëm dhe që është i dështuar nuk ekziston te dija dhe potenciali, por te vullneti. Ai që zotëron vullnet, ka edhe potencial, edhe forcë, ndërsa ai që e humb atë deklaron: “Nuk mundem.”

Përkujdesu për kopshtin tënd me maturi

Mendja është si kopshti, me të cilin nuk duhet të mjaftohesh vetëm që të mbjellim farën e bimëve dhe luleve të bukura, sepse ato do të vyshken dhe treten nëse ti nuk ndërmerri edhe veprime të tjera të rëndësishme si: ujitja, heqja e barit dhe e rrënjëve të dëmshme. Pasi t'i largosh të gjitha mendimet negative që pengojnë përparimin tënd drejt objektivave të tua, do të kesh mundësi të formosh mendime pozitive, të cilat do të ndihmojnë të arrihesh atë që synon. Vetëm atëherë do të provosh shijen e suksesit dhe ai do të bëhet pjesë e pandashme e personalitetit tënd. Njeriu me vetëbesim dhe që ka bindje se është i suksesshëm, nuk dorëzohet pa marrë parasysh se në çfarë pengesash has, vazhdon prapë të përpiqet me ngulm derisa të arrijë qëllimin. Në anën tjetër, vërejmë se ai që sheh në veten e tij vetëm dështimin, bie shumë shpejt qysh në përpjekjen e parë, duke kapitulluar para se të mbërrijë te caku. Në shumicën e rasteve ndodh që pengesa e parë të jenë mendimet e tua negative.

A ka të tjera mendime, të cilat ndikojnë që të kesh dyshim dhe pasiguri për të marrë kontrollin e iniciativës për ndryshim radikal

në jetën tënde? Ka mundësi! Atëherë provo t'i njohësh këto mendime dhe të debatosh rreth tyre në mënyrë shkencore dhe racionale, e më pas shndërroi ato në mendime pozitive dhe të dobishme.

Si ta bësh një gjë të tillë? Ja disa metoda:

- **Mos u bëj koprrac.** Imagjinata është falas, mos ngurro të ëndërrosh gjëra nga më madhështore. Omer b. Abdulazizi, Allahu e mëshiroftë, një ditë i tha ministrit të tij: **“Unë kam shpirt ambicioz. Kam imagjinuar të martohem me Fatimen, bijën e Abdulmelikut dhe jam martuar me të. Kam imagjinuar të bëhem emir dhe jam bërë emir i Medinës. Kam imagjinuar kalifatën dhe jam bërë kalif i tërë muslimanëve. Ndërsa tani imagjinoj xhenetin dhe shpresoj që ta arrij.”** Ëndrrat janë ato që ndezin tek ty entuziazëm dhe forcë për punë, prandaj imagjino për gjëra të mëdha, ngjashëm me Omer b. Abdulazizin, i cili aspiroi xhenetin. A ka gjë më të shkëlqyer dhe më madhështore sesa xheneti?

Shikoje të ardhmen tënde sikur të jetë realitet para teje: mbylli sytë për disa minuta dhe imagjino veten duke e ushtruar vërtetë të njëjtin veprim, të cilin ti shpreson ta praktikosh në të ardhmen. Imagjino sikur je duke banuar në lagjen dhe shtëpinë, të cilën aspiron të banosh, në divanin të cilin e dëshiron dhe të gjitha mobilet, të cilat i ke ëndërruar. Imagjino veten duke e udhëhequr firmën, të cilën aspiron, duke e filluar ditën që nga mëngjesi me buzëqeshje ndaj

“...Dallimi në mes atij që është i suksesshëm dhe që është i dështuar nuk ekziston te dija dhe potenciali, por te vullneti...”

punëtorëve, duke pranuar palë. Imagjino veten sikur je duke folur para një publiku të madh me bindje dhe vetëbesim të plotë...

- **Kujtoje të kaluarën:** Para se ta fillosh të tashmen patjetër duhet t'i braktisësh të gjitha dhembjet e kaluara dhe mbresat e këqija. Nëse nuk ke sukses një herë, kjo nuk do të thotë se do të dështosh përherë. Nëse shikon prapa do të gesh dështime të shumta, të cilat nuk janë përsëritur kurrë. Kur ta shikosh të kaluarën, krijo nga ajo një leksion nga i cili mëson vendet në të cilat ke gabuar, me qëllim që të mos i përsëritësh më kurrë, mirëpo assesi mos u ndal e të vajtosh për to. Edhe përkundër rëndësisë së kujtimit të gabimeve të shkuara dhe përfitimit nga përvoja, patjetër duhet t'i kesh parasysh edhe sukseset që të jesh vigjilent, se ti zotëron aftësitë e duhura për të korrur sukses edhe herëve tjera.

Cilat janë ato ndryshime që duhet t'i bësh në sjelljen tënde

Nëse mëson ta zhvillosh të menduarit tënd që të jetë sa më shumë që të jetë e mundur pozitiv dhe ta filtrosh atë nga mendimet negative, ke bërë hapin e parë për të ndryshuar sjelljen për tek më e mira. Psikologët thonë: "Ju keni mundësi që të fitoni një shprehje të mirë, nëse për 21 ditë me radhë mendoni, flisni dhe veproni ashtu siç ju dikton shprehja e re, të cilën ju dëshironi ta përfitonit." Ky perceptim gradualisht shndërrohet në realitet.

Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Fillimi i çdo shkence teorike dhe veprë praktike janë mendimet dhe meditimet. Ato më pas tërheqin perceptimin, perceptimi vizionin, vizioni shpie tek vullneti, ndërsa vullneti kërkon kryerjen e veprës, përsëritja e shpeshtë e veprës e krijon shprehinë."

Ndërsa në ditët e sotme psikologët thonë: "Idetë e thjeshta dalëngadalë shndërrohen në besime (dogma) dhe qëndrime në sjellje të

vazhdueshme, ashtu që më pas transformohen në zakone, të cilat portretizojnë tiparet e personalitetit."

Që të bësh diçka të dobishme mirëpo të ndryshme, kësaj radhe ke disa mënyra, të cilat me lejen e Zotit do të ndihmojnë që të ndërtoosh qëndrime pozitive të sjelljes:

Përgatite veten për projektin e jetës

Vendose planin e jetës para syve dhe mëso si të arrish tek ai. Lexo për të... fol për të..., merr pjesë në kurse dhe ligjërata që kanë të bëjnë me të, jeto me çdo gjë që ka të bëjë me këtë projekt.

Nëse është projekti i jetës tënde të bëhesh udhëheqës i një firme të madhe, që merret me patundshmëri, atëherë rri me njerëzit që kanë pasur sukses në këtë veprimtari, blej libra që flasin për tregtinë me pasurinë e patundshme, merr pjesë në simpoziumet dhe seminarat, të cilat i organizojnë odat ekonomike dhe përcilli vazhdimisht lajmet dhe të rejat që kanë të bëjnë me këtë lloj biznesi.

Nëse është ëndrra e jetës tënde të marrësh një diplomë në një degë të shkencës, lexo shumë për të, takohu me dijetarët dhe specialistët e asaj dege dhe pyeti për të gjitha gjërat që të interesojnë për këtë lëmi.

Bëhu i përpiktë

Jeta e organizuar është e domosdoshme për të menduarit kreativ. Shpikja nuk zhvillohet në një ambient në të cilin mbretëron kaosi. Nëse fjala e urtë thotë: "Mendja e shëndoshë qëndron në trup të shëndoshë", atëherë ne shtojmë se: "Mendja e përpiktë qëndron në jetën e organizuar."

Le të jetë në gjendje të rregullt dhe të sistemuar vetura jote, shtëpia, tavolina e punës, kompjuteri... etj. Ushtroje rregullin në jetën tënde me automatizëm, sepse nuk të kushton asgjë, dhe ti do të shohësh se çdo gjë bëhet e qartë në mendjen tënde, dhe do të

⚡ Dita e cila të kalon pa realizuar asgjë të rëndësishme, konsiderohet humbje e madhe. Ymri është i kufizuar dhe jeta është e shkurtër, nuk ka vend për ata që rrinë... ”

ndikojë që forca, entuziazmi, gjallëria të lëvizin me shpejtësi në damarët e tu. Përpikëria dhe rregulli ndihmojnë dukshëm që vizioni të të shfaqet më i kthjellët.

Gjeje modelin

Çfarëdo që të jetë projekti dhe ëndrra jote, sigurisht që ti nuk je i vetmi në këtë rrugë, patjetër se ekziston dikush para teje, i cili ka arritur të realizojë diçka që ngjason me projektin tënd. Përgjatë leximit dhe studimit do të njihesh me nismëtarët, zbuluesit dhe kolosët e këtij projekti. Zgjidhe njërin prej tyre, i cili është më i preferuari yt dhe bëje atë shëmbëlltyrën më të lartë, përfito prej tij dhe fillu ku ka mbaruar ai, e jo prej ku ka filluar ai.

Mirëpo, përse të kufizohesh vetëm te njëri? Përse nuk i shkruan në letër tre prej tyre, të cilët i konsideron më të suksesshmit dhe më të përshtatshmit, dhe më pas të shkruash se çfarë vëren të veçantë te secili prej tyre, ngase ka mundësi që kjo të jetë pikërisht ajo që ti synon të arrish. Është shumë e mundur që edhe të ndihmojë ajo çfarë ke shkruar nga përvoja e tyre, që të ka lënë mbresa që ti pastaj t'i formulosh më lehtë synimet e tua.

Filloje ditën në gjendje të mirë

Zgjohu prej gjumit duke buzëqeshur. Ngrihu nga shtrati me qejf dhe me gjallëri. Jeta është e shkurtër, ka shumë gjëra që

mund t'i kryesh sot. E çfarë është jeta, veçse një grumbull ditësh. Dita e cila të kalon pa realizuar asgjë të rëndësishme, konsiderohet humbje e madhe. Ymri është i kufizuar dhe jeta është e shkurtër, nuk ka vend për ata që rrinë.

Medito rreth ajetit të Allahut: *“Për ata nga ju që dëshirojnë të ecin përpara ose të kthehen mbrapsht.”* Zgjidh për vete se: a do të jesh prej atyre që ecin para apo prej atyre që ecin mbrapa. Dije se ndalimi simbolizon mbetjen mbrapa, meqë i tërë universi rrotullohet edhe ecën përpara, ndërsa ti dëshiron të qëndrosh në vend! Vrojto pak edhe për fjalët e tjera të Krijuesit, që thotë: *“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë.”* Si dhe ajetin: *“Çdo gjë që gjendet në Tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më mirë.”* Prandaj ki parasysh se nuk ke zgjidhje tjetër përveç punës, o do të punosh mirë, o keq.

Thyeje zakonin

Ka mundësi që ta kesh të vështirë ta thyesh rrethin e zakoneve dhe shprehive të këqija, të cilat ta humbin kohën dhe nuk u shërbejnë asgjë synimeve të tua. Kjo nuk është diçka e pamundur, nëse me të vërtetë e ke dëshirën dhe vullnetin që ta bësh atë. Çfarëdo që dëshiron të bësh, me vullnetin e Allahut do të arrish ta realizosh. E tërë ajo çfarë kërkohet prej teje është që të praktikosh ligjin e zëvendësimit, i cili kërkon të bësh diçka të re dhe të dobishme, me qëllim që ta largosh shprehinë e keqe dhe ta zëvendësosh atë me një të mirë.

Kështu që sa herë që fiton një shprehi të mirë automatikisht do ta largosh një të keqe dhe në këtë mënyrë do të arrish që të çlirohesh nga rutina jote e përditshme dhe e mjerueshme. I Dërguari i Allahut thotë: *“Kije frikë Allahun kudo që të jesh, të keqen pasojë me të mirë, sillu me njerëzit me moral të*

mirë.”

Ik prej atyre që të akuzojnë me krenari të tepërt dhe ëndrrat e tua i konsiderojnë të krisura dhe të tepruara, ngase mund të të zhvendosin nga rruga e drejtë dhe ty të kaplojë plogështia dhe kështu të dobësohen objektivat. **Ki gjithmonë parasysh, se të gjitha zbulimet, të cilat i shohim sot, për to një ditë është thënë: “E pamundur, kjo është diçka që nuk arrihet.”**

Besoj se prej çasteve më të lumtura të jetës është çasti kur të realizosh diçka që të tjerët e konsiderojnë si diçka që është e pamundur të realizohet.

Të marrim një shembull për të gjitha ato që thamë deri tani:

Nëse synimi yt është që të kalosh këtë vit shkollor me sukses të shkëlqyer, **mendimet e duhura** që duhet t’i kesh janë këto:

- Unë i zotëroj të gjitha komponentët e nevojshme për sukses.

- Unë kam mundësi që të shpik strategjitë e duhura për t’i tejkaluar barrierat.

- Unë e meritoj të jem i suksesshëm në mësim.

Ndërsa **sjelljet dhe veprimet** që duhet të kesh lidhur me këto janë:

- Dëgjo me vëmendje shpjegimin e profesorit dhe pyete për çështjet që nuk i kupton.

- Përsëriti mësimet për çdo ditë së paku dy orë në ditë.

- Në ditën e shtunë dhe të diel bëj përsëritjen e mësimëve katër orë.

- Kërko mostrën e pyetjeve nga testet e kaluara dhe përfito prej tyre. ■

PREZANTIM I LIBRIT:

40 HADITHE

SHKRUAN: BEKIR HALIMI

Shejh Abdulkadër Arnauti (Kadri Sokoli) është një dijetar i madh i hadithit i shekullit tonë. Ai është me origjinë nga Kosova, konkretisht nga Vrella e Istogut. Familja e tij emigroi në Siri dhe aty shejh Abdulkadri rritet e shkollohet. Ai përveç shkollimit merr edhe zanatin e sahatçiu, me të cilin ai e mbajti për një kohë të gjatë familjen e vet. Përveç shkollimit formal ai merr mësim edhe te hoxhallarët e shquar të Shamit në atë kohë, siç janë haxhi Nuh Saati, i ati i shejh Muhamed Nasirudin Albanit, Sulejman Gavoçi, i ati i Vehbi Gavoçit, që të dy hoxhallarë shqiptarë, që kishin emigruar në Sham nga Shqipëria, pastaj nga Subhi Attari, Feiuzudin Atavi, Salih Farfuri etj.

Fillimisht ka punuar në përpunimin dhe përgatitjen për botim të librave nga biblioteka klasike e botimeve islame dhe kohët e fundit ka pasur edhe vepra të veta, të cilat nuk janë ndoshta aq voluminoze, mirëpo janë me peshë të madhe për muslimanët në përgjithësi.

Veprat e tija kryesore janë “Xhamiul Usul fi Ehadithi Resul”, në 11 vëllime, “Zadul Mead fi Hedji Hajril Ibad” në 6 vëllime (këtë libër e ka përpunuar në bashkëpunim me shejh Shuajb Arnautin, i cili gjithashtu është shqiptar nga Shkodra), “Zadul Mesir fi Ilmi Tefsir”, në 8 vëllime, “El Furkan bejne Evlijai Rahman ue Evlijai Shejtan”, “El Furkan bejnel-Haki vel Batili” etj. Kurse prej librave që janë botuar në kohën e fundit janë: “Mbi rrugën e të parëve tanë”, “Porosi profetike”, “40 Hadithe”, “100 Hadithe autentike që tregojnë rrugën drejt Xhenetit” (të përkthyer në

(Fjalë të përzgjedhura mbi akiden, ibadetin, sjelljet dhe etikën nga thëniet profetike të shënuara në mënyrë autentike)

Autor: Abdul-Kadër Arnauti

Boton: Gjurma- botime

Prishtinë, 1428/2007

Përktheu: Ekrem Avdiu

gjuhën shqipe), “Risaletun fi Fadli Shehri Ramadan”, “Er Redu alet Kuttab el Muasirin”, dhe disa libra tjerë, të cilat akoma janë dorëshkrime. Mua personalisht kam pasur nderin që të bëj botimin e disa dorëshkrimeve që na i ka lënë amanet familja e Shejhut të nderuar, djemtë e tij, të cilët me pasion dhe kujdes të madh i mbajnë kontaktet me ne nxënësit e dijes shqiptarë, që kemi pasur kontakte të vazhdueshme me këtë hoxhë kur ka qenë i gjallë. Dorëshkrimet që i kemi në dispozicion për t’i përgatitur për botim kanë këto tituj “El Amul Xhedid - Viti i Ri”, “Thelathune Hadithen- Tridhjetë Hadithe”, “El Alatul Musikije - Instrumentet muzikore”. Jemi shumë të nderuar që na është dhënë mundësia për botimin e këtyre dorëshkrimeve të këtij hoxhe të madh edhe në gjuhën arabe, vepër e cila për ne është një privilegj i veçantë. E lusim Allahun e madh që të na ndihmojë në përpunimin sa më të mirë të tyre dhe botimin e tyre në gjuhën arabe dhe në gjuhën shqipe.

Libri për të cilin po flasim në këtë numër ka disa karakteristika. Një pjesë e karakteristikave kanë të bëjnë me botimin në gjuhën arabe dhe një pjesë me botimin në gjuhën shqipe.

Karakteristikat e botimit në gjuhën arabe mund t’i rrumbullakosim në disa prej tyre, duke filluar nga fakti se përpilimi i këtij libri është vazhdim i Sunetit të dijetarëve të hadithit, meqë një syresh prej tyre kanë shkruar libra me këtë formulë, 40 hadithe, edhe pse ndoshta kanë ndryshuar natyrën e tematikave që i kanë zbërthyer. Mes tyre është Imam Neveviu, Axhuriu, Abdullah b. Mubareku etj. Me këtë vepër shejh



“Ai e shpaloste modestinë e tij duke u nënshkruar pas çdo shkrimi me “shërbëtor i hadithit të Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem”....”

Abdulkadri është radhitur në mesin e dijetarëve të mëdhenj të hadithit në Botën Islame. Ky libër dallon për nga hadithet që janë radhitur në librin “40 Hadithet e Neveviut”, meqë në librin e shejh Abdulkadrit ka 28 hadithe, të cilat nuk gjenden tek libri i Imam Neveviut. Natyra e temave që trajtojnë hadithet tek libri i Imam Neveviut tregon se u dedikohet njerëzve që kanë nivel më të lartë fetar, kanë dije më të mëdha mbi fenë, meqë ndërmjet haditheve të librit ka edhe hadithe që kanë të bëjnë me dispozita fetare, gjë të cilën nuk mund ta gesh tek libri i hoxhës tonë të nderuar Abdulkadër Arnauti, ku shumica e haditheve flasin për inkurajimin në vepra të mira dhe qortimin e veprimit të vep-

rave të këqija. Për këtë leximi i librit të shejh Abdulkadrit është shumë i dobishëm për masën e gjerë muslimane edhe në trevat tona.

Karakteristikat e botimit në gjuhën shqipe kanë të bëjnë me përkthyesin, i cili është një hoxhë me renome në trevat tona shqiptare, njohës i mirë i hadithit të Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, meqë ka kryer fakultetin e vetëm të hadithit në botë, në fakultetin e hadithit në Universitetin Islamik në Medinë, prandaj edhe përkthimi i këtij libri ka disa elemente të cilat duhet të përmenden. Ai me përkthimin e këtij librit ndjek vazhden e komunikimit me hadithin mes dijetarëve dhe popullit musliman dhe e dyta, u ofron shqiptarëve një pjesë të trashëgimisë që ka lënë pas vete ky dijetar i madh shqiptar.

Ai në hyrje të librit i bën një parathënie me titull “në shërbim të Sunetit” ku spikat disa gjëra të rëndësishme nga ky dijetar, prej tyre do të kishim veçuar:

- Faktin se të gjithë shqiptarët duhet të mburren dhe krenohen me faktin se ky dijetar i madh vjen nga bijtë e popullit tonë.

- Ndikimin e Fesë Islame në formësimin e personalitetit të njeriut.

- Madhësinë e një hoxhe e tregojnë dhe e publikojnë nxënësit e vetë hoxhës.

- Hoxhallarët e mëdhenj kundërshtojnë çdo teprim në madhërim nga ithtarët e vet dhe në rastin konkret ai e shpaloste modestinë e tij duke u nënshkruar pas çdo shkrimi me “shërbëtor i hadithit të Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem”.

Përkthyesi në këtë libër ka bërë edhe një shtojcë, e cila, për mua ka qenë një ndërhyrje e dobishme, ku përmend shkurtimisht biografinë e transmetuesve të këtyre haditheve, e cila lexuesit shqiptarë i jep një pasqyrë edhe më të plotë të tematikës ku synon ky libër.

Shejhu në fillim të librit përveç haditheve jep edhe disa sqarime të shkurtra, mirëpo pas pak faqesh mjaftohet vetëm me citimin e haditheve dhe dhënien e vlerësimit të tyre

për nga saktësia. Fakti se shejhu jep edhe vlerësimin e tij për çdo hadith, i cili citohet në këtë libër, ia shton atij edhe më tepër vlerën, meqë është shumë me rëndësi për çdo musliman të dijë gradën e secilit hadith për nga saktësia, sepse përdorimi i haditheve pa ditur saktësinë e tyre është një vepër që ka pasoja negative për dituritë fetare të një muslimani. Ky ka qenë edhe synimi i këtij hoxhe të madh, i cili për një kohë shumë të gjatë ka punuar në dhënien e vlerësimeve profesionale mbi hadithet e përhapura në libra të ndryshëm dhe në mesin e njerëzve. Kjo është një shkencë shumë e ndjeshme dhe e saktë, shkencë të cilën nuk e kanë fetë e tjera dhe është karakteristikë e Fesë Islame. E veçanta për këtë dijetar shqiptar është fakti se ata janë marrë me zanatin e sahatçiu dhe me shkencën e hadithit njëkohësisht, kurse që të dyja këto shkenca janë precize.

Në përfundim do t’ju themi se me dije dhe sinqeritet njeriu arrin grada të larta në dynja e ahiret, këtë e kuptojmë nga ky hadith i Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem: *“Allahu ndriçoftë fytyrën atij që dëgjon prej nesh një hadith dhe ia tregon tjetrit, ndodh që bartësi i fikhut ia shpien atij që është më fekih se tjetri, ndodh që bartësi i fikhut mos të jetë fakih”.* (Sahih, Tirmidhiu).

Për shkak të marrjes me hadithin e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, Allahu u jep këtyre njerëzve kuptim të shëndoshë dhe ymër të gjatë, sikurse e ka komentuar këtë hadith shejh Shuajb Arnauti. Kjo edhe ka ndodhur me dijetarët shqiptarë, që janë marrë me këtë shkencë, sikurse është rasti me shejh Albanin, shejh Abdulkadrin dhe shejh Shuajbin.

Lexoni këto libra, mësoni fenë nga hadithet e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, dhe mësoni peshën që kanë pasur këta dijetarë shqiptarë në Botën Islame.

Allahu u dhëntë mëshirë dhe xhenet këtyre dijetarëve shqiptarë. Amin! ■



XHIHADI I EDUKATËS

Allahu subhanehu ue teala xhihadin e ka bërë mjet udhëzimi. Njerëzit më të udhëzuar janë ata që luftojnë. E luftë më e mirë është: “Të luftosh epshin, hamendjen, dynjanë dhe djallin. Kush i lufton këto katër fenomene Allahu i hap rrugën atij për në xhenet

ADIL B. SA'D EL HAUFI

Pa dyshim që prindi luan një rol mjaft të rëndësishëm në edukimin e fëmijës së tij. Këtë e themi duke u bazuar në hadithin e të Dërguarit të Zotit Muhamedit salallahu alejhi ue selem që thotë: “Çdo foshnje lind në fitre, ndërsa prindërit e bëjnë jehudi, të krishterë apo mexhus

(zjarrputist)”. E përcjell Muslimi.

Pra, prindi është shkaku kryesor, i cili e ndihmon fëmijën e tij, që të zhvillohet dhe të edukohet në rrugë të drejtë, po ashtu ai është edhe mburoja apo antivirusi më efektiv që ai fëmijë mos të bjerë nën ndikimin e dukurive negative. Të udhëzosh fëmijën tënd në rrugë të drejtë është investimi më i madh, që mund të bëjë prindi për atë, sepse ai është kapitali më i

çmueshëm që ai zotëron. Allahu subhanehu ue teala në Kuranin e Tij Famëlartë thotë: *“E ata që besuan, e edhe pasardhësit e tyre ishin me besim, Ne atyre do t’ua shoqërojmë pasardhësit e tyre dhe asgjë nuk u pakësojmë nga veprat e tyre (prindërve). Çdo njeri është peng i asaj që ka punuar.”* (Tur 21.)

Për t’u udhëzuar fëmija në rrugë të drejtë kanë ndikim të madh shumë faktorë, por në këtë shkrim do të mjaftohemi duke përmendur disa prej tyre:

1-Edukata e prindërve

Komentuesi i njohur i Kuranit, Begaviu Allahu e mëshiroftë, kur bën komentin e ajetit ranor: *“...babai i tyre ka qenë njeri i mirë”* (Kehf, 82) thotë: Nëse dikush ka edukatë të mirë dhe është i sjellshëm. Allahu subhanehu ue teala ia ruan: Birin, nipin dhe pasardhësit e tjerë. Seid b. Musejebi thotë: Unë falem vetë, por gjithnjë e përkujtoj birin tim, se edhe ai duhet ta bëjë një gjë të tillë.

Ndërsa Kurtubiu Allahu e mëshiroftë, kur e komenton këtë ajet thotë: Këtu ka argument, se njeriut të mirë i është ruajtur edhe gjeneza e tij. Kjo është bërë për shkak të begatisë së adhurimit të tij. Pastaj është edhe shkak i ngritjes së pozitës së tij qoftë në këtë apo në atë botë.

2-Lutja

Allahu subhanehu ue teala në Kuranin Famëlartë thotë: *“Zoti im, më inspiro mua që të falënderoj për të mirën Tënde, që ma dhurove mua dhe prindërve të mi, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m’i bëj të mirë pasardhësit e mi, unë pendohem te Ti dhe unë jam me muslimanët.”* Ahkaf, 15.

Sejjid Kutubi Allahu e mëshiroftë, kur e komenton këtë ajet në librin e tij “Fi Dhilalil Kuran”, thotë: Kjo është dëshira e besimtarit të mirë, që vepra e tij e mirë të trashëgohet

“E përse të mos e shfrytëzojmë potencialin që zotërojmë, duke investuar tek fëmijët që kur fillojnë t’u dalin thonjtë duke ua mësuar besimin e vërtetë ... ”

tek pasardhësit e tij dhe zemra e tij ta ndjejë se pas tij ka kush e adhuron Allahu subhanehu ue teala. Kjo është kënaqësia shpirtërore e tij dhe pasuria më e madhe që ai len pas.

Atëherë për t’iu lutur Allahut Fuqplotë duhet që ta zgjedhim kohën më të mirë, vendin më të ndershëm, pozitën kur jemi më afër Allahut subhanehu ue teala, me shpresë se do ta gjejmë derën e hapur për t’u pranuar lutjet, që të na përgjigjet Krijuesi ynë i mëshirshëm. Sa nëna e sa baballarë janë lutur për fëmijët e tyre, e kjo është bërë shkak që ata të jenë të lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër. Një gjë të tillë e kanë vepruar edhe të Dërguarit e Allahut subhanehu ue teala, siç na rrëfen Allahu subhanehu ue teala në Kuranin Famëlartë: *“O Zoti im! Më bëj mua nga ata që falin namazin, e edhe prej pasardhësve të mi dhe pranoje lutjen time, o Zoti ynë!”* Ibrahim, 40. Si dhe ajeti tjetër: *“Edhe ata që thonë: “Zoti ynë, na bëj që të jemi të gëzuar me punën e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bëj shembull për të devotshmit.”* Furkan, 74.

3-Lidhjet e tyre me Allahun

Gjëja më parësore për prindërit në edukimin e fëmijëve të tyre është që ata të binden, se gjithnjë janë nën kontrollin e Krijuesit të tyre. E kjo është mburoja më e

mirë për ta ruajtur natyrshmërinë e fëmijës, ua forcon besimin, si dhe i mbron ata që mos të devijojnë nga mësimet që ua këshillon prindi. Sa për ilustrim vlen të përmendim edhe transmetimin e Abdullah b. Abasit radijallahu anhuma, i cili na rrëfen për këshillat që i Dërguari i Allahut, Muhamedi salAllahu alejhi ue selem në një rast e këshilloi dhe i tha: *“O djalosh ruaje Allahun, Allahu do të ruajë ty. Ruaje Allahu do ta gjesh kudo që të jesh. Kur të lypësh, lyp vetëm prej Tij. Kur të kërkosh ndihmë mos kërkë përveç se prej Tij. Dhe ta dish se nëse i gjithë umeti bashkohen që të ndihmojnë, s’kanë mundësi tjetër për të ndihmuar pos asaj që e ka caktuar Allahu për ty. Por edhe nëse tubohen i gjithë umeti që të dëmtojnë, s’kanë për të dëmtuar pos asaj që Allahu ta ka caktuar. Janë ngritur lapsat dhe janë tharë fletushkat”*. E përcjell Ahmedi dhe Tirmidhiu).

4-Shembulli i mirë

Njeriu nga vetë natyra që ka është i nevojshëm për të ndjekur një shëmbëlltë të mirë. Ndërsa shembulli më i mirë për fëmijën janë prindërit, kur fjala e tyre është gjithnjë në përputhje me veprën e tyre, gjë e cila ka ndikim të madh në jetën e tyre të përditshme, qoftë vajzë apo djalë.

Nëse prindi përdor fjalë të mira, edhe fëmija do të mundohet që të përdorë të njëjtat fjalë. Nëse prindi bën vepra të mira, edhe fëmija do të mundohet të bëjë të njëjtën vepër. Nëse prindi falet në xhami, edhe fëmija do të mundohet ta praktikojë një gjë të tillë.

5-Të krijosh personalitet më vete

Sehël b. Sadi radijallahu anhu thotë: Resulullahut sallAllahu alejhi ue selem i sollën ujë për të pirë dhe piu. Ndërsa në anën e djathtë i pranishëm ishte një fëmijë kurse në anën e majtë ishin disa njerëz të

shtyrë në moshë. Pasi piu e pyeti fëmijën: “A më lejon që tua jap një herë të moshuarve pastaj ty!” Fëmija i tha: Fjala jote nuk i krijon armiçësi asaj që më takon. Usame b. Zejdi ishte në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare, kur udhëhiqte ushtrinë muslimane, ku mes tyre kishte nga sahabët e mëdhenj. Muadh b. Xhebeli radijallahu anhu ishte imam në moshë shumë të re. Me shembuj të tillë është e mbushur shkolla ku i ka edukuar Resulullahu salAllahu alejhi ue selem shokët e tij, kështu që në këtë formë ai arriti t’ua krijojë personalitetin atyre dhe kjo ndikoi që ata të jenë në atë pozitë për të cilën bëhet fjalë.

6-Mjedisi

Është shumë me rëndësi që mjedisi të jetë i mirë për fëmijën, sepse ai mund të ketë ndikim pozitiv apo negativ. Për të pasur ndikim pozitiv duhet që fëmija të largohet nga shoqëria e keqe dhe të shoqërohet me shokë të mirë, që të përfitojë sjellje dhe edukatë të mirë. Nëse arrihet kjo, atëherë është shumë vështirë, që ai të ndikohet nga idetë shkatërruese.

7-Investimi tek fëmija

Me këtë kriter nënkuptojmë që tek ata të investohet edukatë, sepse ata janë kapitali më i mirë që zotëron njeriu. Njëkohësisht është një investim që të mbron prej varfërisë para dhe pas vdekjes. Këtë mund ta kuptojmë më së miri nga hadithi i Muhamedit salAllahu alejhi ue selem që thotë: *“Kur vdes dikush nga bijtë e Ademit i ndërpriten të gjitha punët përveç triave: Sadakaja rrjedhëse, dituria e dobishme nga ai dhe fëmija i mirë, i cili lutet për prindërit e tij”*. E përcjell Muslimi.

E përse të mos e shfrytëzojmë potencialin që zotërojmë, duke investuar tek fëmijët që kur fillojnë t’u dalin thonjtë duke ua mësuar besimin e vërtetë fillimisht,

duke ua mësuar Kuranin, hadithin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue sem, parimet fetare, moralin etj.


8-Shoqëria

Prindi e ka detyrim që fëmijën e vet ta udhëzojë që të shoqërohet me shokë të mirë, sepse ai do të ndikohet medoemos nga ai shok. Por nëse shoqërohet me ndonjë shok, i cili nuk është në rrugë të drejtë, ai duhet që ta largojë nga shoqërimi me atë. Njëkohësisht prindi duhet të silltet me fëmijën e vet si shok dhe të hapë dialog që të këmbëjnë mendime ndërmjet tyre, edhe pse fëmija është i vogël.

9-Xhiahadi

Mos të harrojmë se nëse angazhohemi me edukimin e fëmijëve tanë jemi duke zhvilluar një xhihad të madh, sepse në këtë rast je duke e luftuar djallin, të këqijat dhe bindjet që mund ta destabilizojnë shoqërinë. Ibën Kajimi Allahu e mëshiroftë në librin e tij “El Fevaid”, kur flet për ajetin Kuranor: **“E ata, të cilët luftuan për hir Tonë, Ne me siguri do t’i orientojmë rrugës për te Ne”** thotë: Allahu subhanehu ue teala xhihadin e ka bërë mjet udhëzimi. Njerëzit më të udhëzuar janë ata që luftojnë. E luftë më e mirë është: “Të luftosh epshin, hamendjen, dynjanë dhe djallin. Kush i lufton këto katër fenomene Allahu i hap rrugën atij për në xhenet. E kush nuk e lufton ndonjë prej tyre ai është i udhëzuar aq sa ka luftuar, e Allahu e di më së mirë. ■

Përktheu: Enver Azizi



O MOTRA, MËSONI!

Famë, pozitë, pasuri, argumentimi me njerëzit apo debatet me studiues, të gjitha këto janë gjëra që e korruptojnë sinqeritetin e zemrës. Kërkimi i dijes bëhet vetëm për të arritur kënaqësinë e Allahut

HADIXHE XHONS

Nga të gjitha mësimet e Islamit dihet se kërkimi i diturisë dhe kërkimi i të kuptuarit të fesë është një ndër veprat më të mira të adhurimit dhe të bindjes ndaj Allahut. E njëjta gjë vlen edhe për studimin e Kuranit, përpjekja për ta mësuar sa më



“Dituria bën thirrje për veprim, por nëse nuk has në përgjigje atëherë do të largohet...”

I Dërguari, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të, po ashtu tha: *“Kushdo që ndjek një rrugë për të kërkuar njohuri (dije), Allahu do t’ia bëjë atij të lehtë rrugën për në Xhenet. Engjëjt i shtrijnë krahët e tyre në miratimin e kërkuesve të diturisë dhe ata që janë në qiej e në tokë luten për falje për të diturit, madje edhe peshqit në ujë. Epërsia e dijetarit mbi besimtarin është sikurse lartësia e hënës mbi të gjithë trupat e tjerë qiellorë. Dijetarët janë mu ata trashëgimtarët e Pejgamberëve. Të Dërguarit nuk lanë pas vetes dërrhem apo pasuri, në vend të saj pas tyre lanë dijen, kështu që kush ka fituar dituri ka trashëguar një pasuri të madhe.”* E përcjell Tirmidhiu.

shumë që të mundemi, leximi dhe nxënia përmendsh e tij. Të gjitha këto janë ndër veprat më të mira të adhurimit.

Allahu në Kuranin Famëlartë thotë: ***“Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.”*** (Jusuf 12: 108)

I Dërguari, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: *“Kur Allahu i do të mirën një personi, Ai i mundëson atij të kuptuarit e drejtë të fesë.”*

Në ditët e sotme Allahu na ka dhuruar shumë mënyra që e bëjnë më të lehtë kërkimin e dijes, pa mundim dhe pa pasur nevojë të shkojmë jashtë shtëpie, siç është me anë të cd-ve, audio kasetave, kompjuter, internet etj. Motra dhe ju vëllezër gjithashtu duhet të ndiqni rrugën e drejtë për marrjen e diturisë, duke filluar me atë që është më e lehtë para se të filloni me çështje më të vështira. Është gjithashtu thelbësore për të përdorur një qasje të ekuilibruar dhe jo të merrni më shumë seç ju mund të trajtoni në mënyrë që të mos hiqni dorë më pas.

Këshilla për atë që kërkon dituri:

Këshillojmë motrat tona për të ndjekur këshillat në vazhdim:

Të jesh e singertë:

Mos harroni, që kërkimi i ditorisë është vepër adhurimi. Allahu nuk do të pranojë asnjë vepër adhurimi, përveçse kur ajo bëhet sinqerisht për hir të Tij. Famë, pozitë, pasuri, argumentimi me njerëzit apo debatet me studiues, të gjitha këto janë gjëra që e korruptojnë sinqeritetin e zemrës. Kërkimi i dijes bëhet vetëm për të arritur kënaqësinë e Allahut, për të zbatuar urdhrat e Tij dhe për të hequr veten dhe të tjerët nga injoranca.

2. Mëso përmendësh Kurandin:

Mundohu sa më shumë për mësimin e një pjese Kurani për çdo ditë. Përmbaju një orari të përditshëm dhe mëso përmendësh disa ajete. Do të ishte ide e mirë që të angazhohesh me pjesë të vogla e të përditshme, duke mos e rritur intensitetin, edhe nëse ju gjeni kohë apo keni më shumë energji për të vazhduar më tej. Më mirë është një vepër e vogël, por e vazhdueshme, se sa një vepër e madhe, por e ndërprerë e pa vazhdim.

3. Zgjero njohuritë:

Lexo përmbledhje të të gjitha degët e studimeve dhe largohu nga veprat e vogla, duke i lënë për më vonë.

Çdo degë e njohurive ka libra që të japin një qasje graduale, duke filluar me diskutime të shkurtra dhe në fund me analiza të gjata dhe të imtësishme.

Lexoni pak rreth Teuhidit, Hadithit, Fikhut dhe të gjitha degët e tjera të dijes.

4. Kupto dhe mëso përmendsh atë çfarë lexon:

Mundohu sa më shumë për nxënien përmendësh të këtyre teksteve nëse mundesh, sepse nxënia përmendësh është dëshmia nga Kurani dhe Suneti. Kjo do t'ju ndihmojë në rrugën e kërkimit të dijes së duhur. Një dijetar ka thënë: "Kushdo që e mëson përmendsh tekstin është i shquar (i dalluar)."

5. Komentuesit dhe shënimet:

Mundohuni të merrni libra me komentues dhe studiues të besueshëm. Dhe kurrë mos ngurroni për të mbajtur shënime për hapësirat tuaja (paqartësitë) prej librit që ju lexoni. Kjo do t'ju ndihmojë për t'i kujtuar gjërat më vonë.

6. Studimi me një dijetar të besuar apo me ndonjë motër kërkuese të dijes:

Kërkoni dikë që është i angazhuar me ligjërata fetare. Në qoftë se nuk është e mundur, atëherë shikoni për motrat që janë kërkuese të dijes dhe ju veç e keni rrugën përpara të vazhdoni më tej.

7. Largo nga vetja hutinë dhe dyshimet:

Mos filloni me libra që kanë polemika para se të zotëroni bazën e njohurive nga Kurani dhe Suneti.

8. Kërko njohuri që lidhen me ju:

Ju duhet të kërkoni nga njohuritë specifike, që kanë të bëjnë me gratë në Islam për të qenë vajzë, grua dhe nënë e devotshme. Roli i juaj në shoqëri dhe brenda jush në lagje dhe komunitet.

9. Mundohu sa më shumë në shfrytëzimin e mirë të kohës:

Përpiqu që pjesa më e madhe e rinisë dhe e tërë jeta të të shkojë duke mësuar.

“Keni fëmijë, familje, punë të përditshme, këto nuk duhet të jenë pengesë, por këto mund të jenë një shtytje për të mësuar edhe më shumë! ... ”

Mos të mashtrojë zvarritja dhe dëshirat për të ardhmen. Çdo orë e jetës tuaj që kalon nuk mund të zëvendësohet më. Rri larg me çdo gjë që mund të bëhet argëtim dhe pengesë, të cilat ju ndalojnë nga angazhimi i juaj maksimal për të arritur diturinë.

10. Të jesh kreative në gjetjen e kohës:

Keni fëmijë, familje, punë të përditshme, këto nuk duhet të jenë pengesë, por këto mund të jenë një shtytje për të mësuar edhe më shumë! Dëgjo ndonjë ligjëratë audio kur je duke hekurosuar, duke punuar punë dore, pastrimet e shtëpisë, larjen e enëve. Falënderimi i takon Allahut, ju tani po kërkonit dituri dhe po mbërrini t'i përfundoni punët e përditshme gjithashtu. Kjo bën që punët e përditshme të kryhen më shpejt!

11. Ndryshoni mënyrën dhe mjetet për përvetësimin e dijes:

Përdorni një sërë metodash në kërkimin e njohurive, në mënyrë që ju të mos mërziteni, si p.sh. lexim, dëgjim dhe duke shikuar video.

12. Bëhu e durueshme – nuk duhet nxituar:

Rruga është e gjatë dhe e vështirë dhe kush bën përpjekje të fuqishme që në fillim do t'ia arrijë qëllimit.

13. Veproni atë që ke mësuar:

Dituria bën thirrje për veprim, por nëse nuk has në përgjigje atëherë do të largohet.

14. Bëhu modeste:

Hap sytë nga dy rreziqe: arroganca dhe zilia shkatërruese (hasedi).

Dijetarët e hershëm në fillim dëgjonin të gjithë ata që ishin më të vjetër, në mënyrë që të mësojnë sjelljet e mira, si dhe ata që ishin më të rinj, në mënyrë që të mësojnë modestinë. Një nga dijetarët e hershëm tha: “I ndrojturi apo mendjemadhi nuk do të kërkojë ndonjëherë dituri.” Pra, droja nuk duhet t'ju ndalojë rreth kërkimit të pyetjeve rreth Islamit. Edhe arroganca është e dëmshme në këtë botë, edhe në botën tjetër; një nga efektet e dëmshme në këtë botë është se ajo e mban një person larg nga të mësuarit dhe të pyeturit.

15. Kërko ndihmën e Allahut:

Ju duhet të kërkonit ndihmën e Allahut, në ndjekje të ditorisë tuaj dhe në Davet. Mbështetu tek Allahu duke i pasuar rregullat e duhura. Duke iu lutur Atij që t'i bëjë gjërat më të lehta. Të gjitha këto janë gjërat më të mëdha, këto janë pothuajse të gjitha mjetet më të dobishme për t'ia arritur qëllimit.

Allahu e di më së miri. Nuk ka kohë më të mirë se sa sot për të filluar. ■

Përktheu dhe përshtati: Burbuçe Rexha

ZHVILLIMI I EMBRIONIT NJERËZOR (1/2)

Tre fazat e zhvillimit të embrionit: 'nutfa', alaka, dhe mudga, flasin për një të vërtetë shkencore, të cilën Kurani i Madhërishëm e ka përmendur që para 14 shekujsh, gjë që pa diskutim është një mrekulli shkencore, e cila dëshmon se Kurani është Libër i Zotit dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.

SHKRUAN: ISMAIL BARDHOSHI

Ajetet që flasin për këtë çështje:

"O njerëz, nëse ju dyshoni në ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej nutfes (pikës së farës; spermatozoidi mashkullor, i cili fekondon vezën femërore), pastaj prej alakas (një copë gjaku e mpiksuar), pastaj prej mudgas (një copë mishi në formën e diçkaje të kafshuar), me trajtë të plotë ose jo të plotë (me trajtë të plotë është fetusi që lind i gjallë, kurse jo i plotë është ai që dështon), me qëllim që t'jua bëjmë të qartë juve Fuqinë tonë". (Haxh: 5).

"Ne e krijuam njeriun (Ademin) prej një cope balte. Pastaj e bëmë atë si një pikë në një vend të sigurt. Pastaj e shndërruam



pikën në alek, pastaj alekun e shndërruam në mudga (diçka e kafshuar)...". (Muminune: 12- 14).

Hadithet që flasin për këtë çështje:

Abdullah b. Mesudi thotë: Na ka thënë i Dërguari i Allahut, i cili thotë vetëm të vërtetën dhe i cili është i frymëzuar nga Allahu me të vërtetën: ***"Secili prej jush mbliidhet dhe formohet në barkun e nënës dyzet ditë si 'nutfe', pastaj shdërrohet në 'aleka' në një periudhë të këtillë, pastaj shndërrohet në 'mudga' po në një periudhë të tillë. Pastaj Allahu dërgon një melek, i cili fryn në të shpirtin dhe urdhërohet të shkruaj katër gjëra: riskun e tij, exhelin e tij, punët që do të kryej dhe a do të jetë i lumtur apo i mjerë".***

Sipas një varianti të këtij hadithi që shënohet tek Buhariu, Pejgamberi

salallahu alejhi ue selem, thotë: “Dhe dërgohet meleku e urdhërohet të shkruaj katër gjëra, më pas meleku fryn në të shpirtin”.

Malik b. Huvejrithi tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Kur Allahu do të krijojë një njeri, burri bën marrëdhënie me gruan dhe fara e tij qarkullon në trupin e femrës, dhe kur vjen dita e shtatë, Allahu e mbledh farën në mitër dhe i sjell shëmbëllimin e çdo paraardhësi ndërmjet tij dhe ndërmjet Ademit, pastaj i jep shëmbëllimin e njërit prej tyre”. Pas kësaj Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, lexoi ajetin e Kuranit: “**Të formësoi në atë shëmbëllim që desh!**” (Infitar: 8). Shënojnë Taberaniu dhe Ibën Mendeh. Albani e ka klasifikuar në serinë e haditheve të sakta (3330).

Buhariu dhe Muslimi shënojnë hadithin e përcjellë nga Ebu Hurejra, i cili rrëfen se një burrë shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe tha: Gruaja ime ka lindur një djalë të zi. Në këtë mënyrë, -tregon Ebu Hurejra, - ai e hidhte fjalën për mohimin e tij. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, e pyeti: “A ke deve?” - “Po”, - u përgjigj ai. - “Çfarë ngjyre kanë?” - “Të kuqe”. “A ka ndër to të murrme?” - Po, - tha ai. “Nga i ka ardhur kjo ngjyrë?” “O i Dërguari i Allahut! Mbase i ka ngjarë një rrënje të mëparshme (d.m.th., ndoshta i ka ngjarë një deveje paraardhëse që ka qenë me ngjyrë të murrme). Atëherë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, tha: “Edhe ky ndoshta i ka ngjarë një rrënje paraardhëse (d.m.th., edhe ky ndoshta i ka ngjarë një paraardhësi të zi nga ana jote ose nga ana e gruas tënde)”.

Në Sahihun e Muslimit shënohet se Hudhejfe b. Usejdi ka përcjellë, që i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *Kur nutfë kalon dyzet e dy net, Allahu i dërgon një melek, i cili i jep*

formën, i krijon dëgjimin, shikimin, lëkurën, mishin dhe kockat, e pastaj thotë: O Zot im! A mashkull apo femër? Kështu, Zoti yt vendos atë që do dhe meleku shkruan. Pastaj meleku thotë: O Zot im, sa do të jetë exheli i tij. Kështu, Zoti yt thotë çfarë do dhe Meleku shkruan. Pastaj meleku thotë: O Zot im, sa dhe cili do të jetë risku i tij? Zoti yt përcakton çfarë do dhe meleku shkruan. Pas kësaj meleku del me fletushkën në dorë dhe nuk shton e as nuk pakëson gjë nga ajo që iu diktua”.

Sipas një varianti tjetër të hadithit të Hudhejfe b. Esidit te Muslimi thuhet se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Meleku hyn te ‘nutfë’ dyzet ose dyzet e pesë net pasi ka zënë vend në mitër dhe thotë: O Zot, do të jetë i mjerë apo i lumtur? Kështu shkruhet njëra prej tyre. Thotë: O Zot, mashkull apo femër? Shkruhet njëra prej tyre. Gjithashtu shkruhet puna që do të bëjë, jeta, exheli dhe risku i tij dhe pastaj palosen fletët dhe as nuk shtohet e as nuk pakësohet gjë në to”.

Sipas një versioni të tretë të këtij hadithi po te Muslimi, thuhet: “Nutfë qëndron në mitër dyzet dit, pastaj zbret në të meleku dhe thotë: O Zot, mashkull apo femër? Kështu Allahu e bën mashkull ose femër. Thotë: O Zot! Sakllam apo jo? Allahu e bën sakllam ose jo sakllam. Pastaj meleku pyet: O Zot! Sa do jetë risku i tij? Cili do jetë exheli i tij, Cili do të jetë karakteri i tij? Pas kësaj, Allahu e bën të mjerë ose të lumtur”.

Sipas një versioni të katërt po te Muslimi thuhet: “Për këqyrjen e nutfes është ngarkuar një melek”. Kështu, kur Allahu do të krijojë diçka me lejen e Vet pasi kalojnë dyzet e ca net ...” vazhdon hadithi si në versionet e tjera.

Buhariu dhe Muslimi shënojnë hadithin e përcjellë nga Enesi, se Pejgamberi

salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Allahu ka ngarkuar një melek për mitrën dhe në varësi të fazave të zhvillimit të embrionit ky melek thotë: O Zot, është bërë nutfa, O Zot është bërë alaka, o Zot është bërë mudga. Kur Allahu do të shfaqë vendimin dhe paracaktimin e tij për krijimin e diçkaje, Ai e shfaq. Meleku vazhdon e thotë: O Zoti im! Do të jetë mashkull apo femër? Do të jetë i mjerë apo i lumtur? Sa është risku? Cili është exheli? Kështu të gjitha këto shkruhen, ndërkohë që njeriu është në barkun e së ëmës”.*

Qëllimi i citimit të të gjitha këtyre haditheve dhe varianteve të tyre është se ato sqarojnë njëra-tjetrën dhe nxjerrin në pah qëllimin e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem. Në mënyrë që konkluzionet e nxjerra nga hadithet të jenë të sakta, ato duhet të dalin nga shqyrtimi i të gjitha citateve dhe të dhënave që kanë të bëjnë me to. Po ashtu duhet të merret parasysh edhe shpjegimi që japin dijetarët për këto hadithe.

Sipas hadithit të Hudhejjes shkrimi i

“Meqenëse në kohën tonë njerëzit janë kryesisht të dhënë pas zbulimeve, kërkimeve dhe të dhënave shkencore, Kurani i Madhërishëm si mrekullia më e madhe e Profetit, pa diskutim përmban të vërteta, të cilat i sfidojnë e i gjunjëzojnë përgënjeshtresit...”

gjërave të lartpërmendura bëhet në krye të dyzet ditëve ose dyzet e ca ditëve, kurse nga hadithi i Ibën Mesudit mund të kuptohet se shkrimi bëhet në krye të njëqind e njëzet ditëve. Për bashkimin mes këtyre haditheve dijetarët kanë dhënë disa mendime, por më e pranueshme është se shkrimi bëhet në krye të dyzet ditëve ose dyzet e ca ditëve. Sipas këtij mendimi me fjalën **‘thumme- pastaj’** është synuar renditja e të dhënave dhe jo renditja e gjërave për të cilat jepen të dhëna.

Në Musnedin e “Bezarit” shënohet se Ibën Omeri ka treguar që Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *Kur Allahu krijon njeriun, meleku i caktuar për këqyrjen e mitrave thotë: O Zot, mashkull apo femër? Kështu Allahu i jep urdhër melekut, që të shkruajë atë që ka vendosur. Pastaj meleku thotë: O Zot, i mjerë apo i lumtur? Kështu Allahu e urdhëron melekun të shkruajë atë që ka paracaktuar. Më pas meleku shkruan midis dy syve të fetusit gjithçka që do t’i ndodhë, deri edhe fatkeqësitë që do t’i ndodhin”.* Nga ky hadith kuptohet se meleku i shkruan gjërat midis syve të fëmijës, kështu që nga hadithet del se meleku i shkruan edhe në fletushkë edhe midis dy syve të fëmijës.

Nga hadithet po ashtu mësohet se Allahu cakton një melek, i cili e këqyr vazhdimisht ‘nutfen’, dhe prandaj kur bëhet nutfe thotë: *O Zot është bërë ‘nutfe’...* Kështu meleku shpreh fazat në të cilat kalon zhvillimi i embrionit, me urdhër të Allahut, edhe pse Allahu e di një gjë të tillë. Pra, meleku shprehet dhe vepron në disa etapa. Së pari, kur embrioni është nutfa. Së dyti, kur është ‘alaka’. Së treti, kur bëhet ‘mudga’. Së katërti, vepron për formësimin e mëtejshëm dhe përsosjen e krijimit dhe të dëgjimit, shikimit, lëkurës, mishit, kockave etj. Së pesti, dërgohet, hyn dhe i shkruan gjërat e parapërmendura në krye

të dyzet netëve ose dyzet e ca netëve, gjë që ndryshon në varësi të zhvillimit dhe formimit të embrionit, pasi embrioni mund të marrë formën e plotë si njeri në dyzet ditë, ose pak para dyzet ditëve, ose pak pas dyzet ditëve. **E gjashta**, pas njëqind e njëzet ditëve i fryn shpirtin.

Nga hadithi i Hudhejfe b. Esidit kuptohet se formësimi i embrionit dhe krijimi i dëgjimit, shikimit, lëkurës dhe kockave plotësohet në krye të dyzet ditëve. Kjo do të thotë se fazat 'nutfa', alaka dhe mudga zhvillohen gjatë dyzet ditëve të para. Ibën Rexhebi ka përmendur se edhe thëniet e dijetarëve të mjekësisë janë në përputhje me këtë fakt. Sipas tyre embrioni mund të formësohet në krye të 35 ditëve, ose dyzet ditëve, ose e shumta në krye të 45 ditëve. Hadithi i Malik b. Huvejrithit, i cili flet për mbledhjen dhe ngjizjen e nutfas në ditën e shtatë, tregon se zhvillimi i organeve të trupit fillon që në ditën e shtatë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne e krijuam njeriun nga ‘nutfa’ e përzier (emshaxh)”**. Disa dijetarë të hershëm janë shprehur se fjala 'emshaxh' nënkupton venat e gjakut që gjenden në nutfa. Rrjedhimisht zhvillimi i organeve të fetusit fillon para dyzet ditëve dhe kompletohet në krye të dyzet ose dyzet e ca ditëve. Edhe hadithi i Ibën Mesudit duhet të shpjegohet në përputhje me këtë fakt, pasi sipas një transmetimi që përmend Taberaniu edhe vetë Ibën Mesudi ka thënë që fëmija mund të formohet para dyzetëditëshit të tretë.

Tre fazat e zhvillimit të embrionit: 'nutfa', alaka, dhe mudga, flasin për një të vërtetë shkencore, të cilën Kurani i Madhërishëm e ka përmendur që para 14 shekujsh, gjë që pa diskutim është një mrekulli shkencore, e cila dëshmon se Kurani është Libër i Zotit dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.

Allahut i Lartësuar i dha Muhamedi

salallahu alejhi ue selem, shumë shenja e mrekulli, të cilat dëshmojnë që është i Dërguari i Allahut, si Israja dhe Miraxhi, çarja e hënës, gufimi i ujit midis gishtërinjve të tij, shtimi e begatimi i ushqimit dhe i ujit, mallëngjimi i filizit të palmës, shërimi i disa sëmundjeve me lejen e Allahut etj. Mirëpo mrekullia dhe shenja më madhe e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, është Kurani.

Allahu i Lartësuar e bëri Kuranin mrekullinë më të madhe të Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, ngaqë mesazhi i tij është për të gjithë popujt dhe për të gjitha brezat. Mesazhi i tij vlen për çdo kohë dhe për çdo vend. Prandaj Allahu i shpalli Kuranin (fjalën), si sfidë ndaj përgënjeshtresve të të gjitha kohëve deri në Ditën e Gjykimit. Po të ishte mrekullia më e madhe e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, diçka materiale, sikurse e kanë pasur të dërguarit para tij, ajo do të gjunjëzonte vetëm njerëzit që e shikonin, dhe pas kësaj do të mbetej një tregim, që do të përcillej nga njerëzit, dhe jo një realitet i prekshëm, i kapshëm dhe i dëshmuar nga njerëzit e çdo kohe, sikurse është Kurani i Madhërishëm. Allahu i Lartësuar thotë: **“Sikur të donim Ne, do të zbritnim nga qielli një shenjë, para së cilës ata do të përulnin kokat.”** (Shuara: 4). Atëherë Allahu e bëri Kuranin mrekulli të gjallë e të përjetshme, për t'i nënshtruar, përulur e gjunjëzuar njerëzit në çdo kohë.

Mrekullia e Kuranit qëndron në katër aspekte:

1- Stili, ndërtimi dhe retorika gjuhësore. Arabët në kohën e Pejgamberit shquheshin për poezi e ligjërime. Ata ishin të zotët e fjalës dhe retorikës. Ata ngrinin juri të veçanta për vlerësimin e poezive dhe ligjërimeve dhe i varnin në muret e Qabesë. Megjithatë Allahu u bëri sfidë duke u kërkuar të sillnin, a të hartonin qoftë edhe

“Fakti që njeriu i kohës tonë di më shumë ligjësi natyrore, të dhënat e të cilave janë akumuluar me kalimin e kohës, dhe arrin të fluturojë në hapësirë, nuk do të thotë se ka aftësi logjike e perceptuese më shumë se njeriu i kohëve të shkuara..”

një sure si të Kuranit, por ata nuk mundën ta bënin një gjë të tillë, edhe pse ishin të interesuar të mposhtnin Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, Allahu thotë: *“Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robrit tonë, atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj që i adhuronin në vend të Allahut, nëse janë të sinqertë. Nëse këtë nuk e bëni dhe kursesi nuk do të mundeni ta bëni, atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët dhe që është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit.”* (Bekare: 23-24).

2- Lajmërimi për gjëra që kishin ndodhur më herët dhe që nuk i dinte askush, si dhe lajmërimi për gjëra që do të ndodhin në të ardhmen, siç është rasti i betejës që u zhvillua mes romakëve dhe persianëve, të cilën e fituan Romakët, fitore kjo për të cilën Allahu flet në fillimin e sures Rrum.

3- Kodet ligjore, të cilat rregullojnë marrëdhëniet e njeriut me Zotin, marrëdhëniet e njeriut me njeriun dhe marrëdhëniet e njeriut me krijesat e tjera.

4- Të vërtetat shkencore, të cilat përputhen me atë që është zbuluar në kohën tonë, siç është zhvillimi i embrionit njerëzor, krijimi i maleve si kunja për stabilizimin e tokës, rrumbullakësia e tokës, e shumë të tjera.

Allahu i Lartësuar ka bërë që shenja më e madhe që i jepej të Dërguarit të përbënte sfidë ndaj njerëzve në ato fusha, ku ata shquheshin më shumë. P.sh., në kohën e Musait dhe pikërisht në Egjipt ishte shumë e përhapur magjia dhe magjistarët. Njerëzit ishin shumë të dhënë pas magjisë. Prandaj Allahu i dha Musait si shenjën më të madhe, shkopin, me të cilin ai arriti t'i mposhtë magjistarët. Në kohën e Muhamedit salallahu alejhi ue selem, njerëzit ishin të dhënë pas fjalës. Ligjëruesit, oratorët dhe poetët e asaj kohe i magjepsnin njerëzit me aftësitë e tyre komunikuese, ndaj edhe Allahu i sfidoi me anë të Kuranit. Meqenëse në kohën tonë njerëzit janë kryesisht të dhënë pas zbulimeve, kërkimeve dhe të dhënave shkencore, Kurani i Madhërisëm si mrekullia më e madhe e Profetit, pa diskutim përmban të vërteta, të cilat i sfidojnë e i gjunjëzojnë përgënjeshtresit edhe në këtë fushë, sepse siç u tha Kurani është shenjë dhe mrekulli e vazhdueshme, një karakteristikë kjo e mesazhit të Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, në tërësi. Zoti thotë në Kuran: *“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kurani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti Yt është Dëshmues i çdo gjëje?”* (Fusilet: 53).

Mirëpo në lidhje me këtë çështje duhet të bëjmë disa sqarime:

Së pari, kjo që u tha më lart është përgjigja më e mirë që mund t’u jepet atyre që janë skeptikë ndaj mrekullive shkencore

të Kuranit dhe që e shohin me dyshim këtë aspekt të mrekullisë së Kuranit.

Së dyti, sipas konceptit tonë si muslimanë burimet e të ardhurave janë të balancuara me nevojat e njerëzve. Allahu i Lartësuar thotë: **“Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij, por prej tij Ne japim me masë të caktuar.”** (Hixhër: 21). Nga kjo del se kur shtohen njerëzit dhe për pasojë edhe nevojat e tyre, atëherë shtohen edhe burimet në mënyrë që të ruhet ekuilibri i përmendur. Kjo është ligjësia që ka vënë Allahu për burimet dhe për nevojat e njerëzve. Nisur nga ky fakt, edhe zbulimet e burimeve të ndryshme gjatë gjithë kohëve janë në përputhje me këtë ligjësi. Allahu e ka bërë njeriun mëkëmbës në tokë dhe e ka pajisur me aftësi për të zbuluar ligjësitë e burimet natyrore dhe për t'i vënë në shërbim të tij. Prandaj Allahu u bën të mundur njerëzve nga një kohë në tjetrën të zbulojnë ligjësi, që nuk njiheshin më parë. Ndonëse në kohën tonë janë bërë zbulime marramendëse për shumicën e njerëzve, zbulimi i ligjësive të ndryshme natyrore është një proces që ka ekzistuar në të gjitha etapat e historisë njerëzore dhe nuk e ka zanafillën në kohën tonë. Fakti që njeriu i kohës tonë di më shumë ligjësi natyrore, të dhënat e të cilave janë akumuluar me kalimin e kohës, dhe arrin të fluturojë në hapësirë, nuk do të thotë se ka aftësi logjike e perceptuese më shumë se njeriu i kohëve të shkuara, pasi sot me të vërtetë vëllimi i njohurive dhe i të dhënave është më i madh, por kjo nuk do të thotë se edhe aftësitë logjike e perceptuese të njeriut të sotëm janë më të mëdha. Pra, në fakt është zgjeruar gama e njohurive, por nuk është zhvilluar mendja e njeriut. Aftësitë mendore të njeriut nuk shkojnë drejt shtimit e përsosjes, por drejt dobësimit dhe pakësimit. Të thuash se sasia e madhe e

njohurive që njeriu zotëron sot lidhur me ligjësitë natyrore është një tregues për evoluimin e mendjes, është njësoj sikur të thuash, se njohja e punëve të dynjasë dhe vënia pasuri është një tregues se i pasuri është më i mençur se i varfëri, gjë që është e pavlefshme, sepse siç dihet kryesisht dijetarët kanë qenë të varfër. Madje edhe ata që kanë bërë zbulime shkencore kanë qenë të varfër. Me përjashtim të studiuesve të kohës sonë, të cilët i përdorin zbulimet dhe teknologjinë për t'u pasuruar e për të bërë dynja. Sikurse pasuria e dynjaja nuk e ngre njeriun, po qe se nuk e përdor për t'i bërë ibadet Allahut, po ashtu edhe njohuritë shkencore, që janë pjesë e dynjasë nuk e nderojnë njeriun, nëse nuk i përdor për të përmbushur qëllimin për të cilin Allahu e ka sjellë në dynja. Një njeri i thjeshtë që di fare pak nga punët e dynjasë dhe njohuritë shkencore, por që e njeh Zotin, e beson Ahiretin, e di se dynjaja është vendkalim, se dynjaja nuk duhet të jetë qëllimi i njeriut, pasi ajo do të zhduket, është më i mençur dhe më i nderuar se një zbulues, studiues, kërkues që njeh shumë ligjësi të jetës e të natyrës dhe nuk i tejkalon këto caqe për të njohur e për të adhuruar Krijuesin e jetës dhe Krijuesin e ligjësive natyrore. Kështu muslimani e shikon përparimin ekonomik dhe progresin teknologjik si pjesë të dynjasë, e cila assesi nuk duhet ta shushasë e ta bëjë për vete. Zoti thotë: **“O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë shejtani, duke ju larguar nga rruga e Allahut.”** (Fatir: 5). Po ashtu thotë: **“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!”** (Ankebut: 64). ■

(vijon në numrin e ardhshëm)

ISLAMI DHE KOTËSITË

Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, përcjell se i Dërguari i Zotit, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “PREJ ISLAMIT TË MIRË TË NJERIUT ËSHTË LËNIA E GJËRAVE QË NUK KANË TË BËJNË ME TË”.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Ky hadith transmetohet nga sahabiu Ebu Hurejre, gjithashtu edhe nga tabiini Ali b. Husejn (b. Ali b. Ebi Talibi) i cili e përcjell drejtpërdrejt nga Profeti, salallahu alejhi ue selem.

Hadithin me këtë kuptim, por me zinxhirë të ndrshëm transmetuesish e shënojnë Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 2318. Ibën Maxhe, nr. 3976. Maliku në “Muveta” nr. 1402, Ahmedi në “Musned” 1/201, Ibën Hibani nr. 229, Bejhekiu në “Shuabul iman”, Ebu Nuajmi në “Hilje”.

Hadithi sipas imam Tirmidhiut konsiderohet hasen-i mirë, kurse bazuar në bashkimin e të gjithë zinxhirëve të këtij hadithi e saktëson Ibën Hibani në “Sahihun” e tij me nr. 229, Ibën Abdulberri në “Temhid”, 9/197, Neveviu dhe Albani në Sunenin e Tirmidhiut, nr. 2317-2318.

Rëndësia e hadithit:

Ky hadith është bazë e haditheve që flasin rreth edukatës islame dhe njëri prej haditheve, i cili i vendos rregullat apo bazat e moralit dhe shkencës së etikës. Muhamed b. Ebi Zejdi, njëri ndër imamët e medhhebit maliki thotë: “Hadithet mbi të cilat qëndron mirësia dhe përmbledhet në to i tërë hairi janë katër: I pari: (*Kush beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit le të flasë fjalë të mira ose le të heshtë*), i dyti: (*Prej Islamit të mirë të njeriut është lënia e gjërave që nuk kanë të bëjnë me të*), i treti: (*Këshilla e Profetit, salallahu alejhi ue selem; “Mos u zemëro”*), i katërti: (*Besimtari do për vëllain e tij -besimtar- atë të mirë që do për veten e vet*).

Komentimi i hadithit:

Fjala e Profetit, salallahu alejhi ue selem: “Prej Islamit të mirë të njeriut”

Kjo fjali bart në vetvete disa njohuri nga të cilat do të përfitonim shumë, ku ndër to do të veçonim:

Fjala: “Prej Islamit” ka si qëllim sqarimin e faktit, se Islami është një mori rregullash, kërkesash, detyrimesh, ndalesash etj., pra Islami është një bashkësi e madhe, e cila ndërtohet së pari mbi besimin, adhurimin, bashkëpunimin mes njerëzve e pastaj mbi moralin. Në



këtë hadith përmendet fjala “prej” që nënkupton se kjo veti e mirë vërtetë është e kërkuar nga besimtari, por assesi nuk duhet keqkuptuar, se ai është i tërë Islami e kështu njeriu të mundohet të praktikojë vetëm atë dhe t’i lërë anash kërkesat e tjera. Asnjëri nuk duhet të arsyetohet për mos-adhurimin e tij me këtë pjesë të hadithit, duke thënë se në shikoj punën time dhe nuk më interesojnë të tjerët e kështu me këtë pretendim t’i sakrifikojë të gjitha adhurimet, duke u munduar që t’i kritikojë shpesh njerëzit e devotshëm, se si ai nuk është askush.

–“Prej Islamit” gjithashtu ka si qëllim, se nëse njeriu nuk i lë anash gjërat që nuk kanë të bëjnë me të për shkak të Islamit, por për shkaqe të tjera atëherë nga kjo veti e tij nuk do të ketë shpërblim në botën tjetër. Për sa i përket kësaj bote mund të përfitojë në mënyra të ndryshme prej kësaj vetie e ky përfitim është shpërblim nga Zoti për të në dynja që në botën tjetër mos t’i mbetet asgjë. Në këtë rregull futen të gjitha punët e mira që bëhen nga jomuslimanët qofshin ato punë fizike, ideologjike, bamirësie etj., e persona të tillë lejohet të falënderohen për veprat e tyre, sepse falënderimi i kujtdo për punën që bën është edukatë islame, mirëpo nuk lejohet lutja për ta nëse dihet me siguri se kanë vdekur jomuslimanë.

–“Prej Islamit të mirë” kuptohet se njeriu mund të ketë Islam apo të themi më mirë mund të pretendojë se ka Islam në vetvete, por në realitet veprat e tij vërtetojnë të kundërtën tek ai. Nuk është me rëndësi të pretendojë njeriu se ka Islam në vetvete, por me rëndësi është fakti që Islami i tij të jetë i mirë. Me fjalën “Islam i mirë” nuk kam si qëllim të vërtetoj se ka Islam të mirë dhe të keq, sepse kjo nuk është aspak e vërtetë, sepse Islami origjinal i zbritur nga Allahu i tëri është i mirë e në të nuk ka asgjë të keqe. Me Islam jo të mirë është si qëllim Islami, të cilit disa nga “besimtarët” e praktikojnë dhe

e propagandojnë tek të tjerët. Islam ky jo mirë i kuptuar nga ata praktikues e pastaj është shumë normale që të interpretohet nga vetë ata shumë më keq se sa ç’është kuptuar. Fakt ky i cili vërehet qartë tek disa muslimanë, të cilët në vend që t’ua lakmojnë të tjerëve fenë, e cila është për t’u lakmuar dhe për t’u pasur zili, ata jua tallin atë si jomuslimanëve ashtu edhe disa muslimanëve fillestarë dhe jo-të qëndrueshëm në fe. Të jesh shkaktar për t’ia lakmuar dikujt Islamit është pasuri, kurse të jesh shkaktar për ta shëmtuar atë, atëherë kjo është humbje për njeriun dhe një person i tillë konsiderohet kriminel kundër Islamit dhe kundër njerëzimit. Jo muslimanët çdo njeri e marrin si shembull duke menduar se ashtu është Islami dhe veprat e individëve nuk i konsiderojnë si punë private të një njeriu të caktuar, por i fusin në të njëjtin thes të gjithë besimtarët. Në këtë pikë nuk dua të lë pa i përmendur edhe disa dashamirës dhe praktikues të Sunetit, të cilët duke dashur të praktikojnë një traditë të caktuar të Profetit, salallahu alejhi ue selem, bien ndesh me shumë tradita apo Sunete të tjera. Ky fenomen nuk është aspak për t’u pasur lakmi.

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi veselem: “*Është lënia e gjërave*”

Gjërat ndahen në dy grupe kryesore, gjëra që kanë të bëjnë me fenë dhe të tjerat që kanë të bëjnë me dynjanë. Gjërat që kanë të bëjnë me fenë ndahen në tre grupe kryesore: besim me zemër, vepër me gjymtyrë dhe shprehje me gojë. Ndërsa gjërat e dynjasë ndahen në dy grupe kryesore vepra me gjymtyrë dhe shprehje me gojë. Lënia e gjërave që nuk i interesojnë njeriut ka si qëllim gjërat e llojit të dytë, pra ato të dynjasë e jo ato të fesë. Kjo për arsye se gjërat që kanë të bëjnë me fenë doemos kanë të bëjnë me besimtarin.

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: “*Që nuk kanë të bëjnë me të*”

Besimtari nëse dëshiron të konsiderohet prej atyre që bartin në vetvete Islam të mirë, ashtu si e kërkon vetë feja, atëherë duhet të largohet nga gjërat që nuk i interesojnë atij. Natyrisht që lind pyetja, se nga cilat gjëra duhet larguar, sepse ka shumë gjëra, bile edhe të mira, të cilat ka raste kur nuk kanë të bëjnë me një besimtar? Për ta sqaruar këtë pikë së pari do të bëjmë një ndarje të gjërave që nuk kanë të bëjnë me neve. Më lart përmendëm se vetë gjërat në përgjithësi ndahen në dy grupe: ato që kishin të bënin me fenë dhe ato që kishin të bënin me dynjanë. Tani do të përmendim ndarjen e gjërave që nuk kanë të bëjnë me ne dhe prej të cilave duhet larguar. Ndonjëherë njeriu i braktisë ca gjëra për shkak të epshit ose për shkak të fesë. Ato që i braktisë për shkak të epshit të tij dhe nuk i vepron nuk shpërblehet për to, kjo për arsye se nuk i ka lënë për hir të Zotit, por i ka lënë se nuk i pëlqejnë nga natyrshmëria e tij si p.sh. dikujt nuk i pëlqen mishi i derrit, apo alkooli dhe nuk i përdor ato, ngase dëmtohet prej tyre e jo se i bën për adhurim.

Këtu futet lënia e të dy llojeve të gjërave, ato të fesë dhe ato të dynjasë. Gjërat e dynjasë nëse i lë për shkak të epsheve parimisht nuk shpërblehet e as nuk dënohet, kurse për lënien e gjërave fetare për shkak të epshit, pa dyshim që dënohet. Kjo sepse është duke i lënë disa nga adhurimet e Allahut.

Kurse lloji i dytë, braktisja e gjërave për shkak të fesë, nëse ato i lë jo pse nuk ia ka qejfi, ngase ai ndoshta ato gjëra mund t'i dojë shumë, mirëpo i lë për Allahun pa dyshim që ai shpërblehet për to. Në këtë braktisje për shkak të fesë futen të gjitha llojet e shirkut, haramit, bidatit, mekruhrit edhe mubahit (kur ai teprohet). Në këto lloje futen si shirku me zemër ashtu edhe ai me gojë dhe me gjymtyrë. (E njëjta gjë vlen edhe për haramin dhe të tjerat pas tij)

Dijetarët kur e komentojnë fjalën “*nuk kanë të bëjnë me të*” ndër të tjera përmendin

edhe këto fjalë:

- Mulla Ali Karriu thotë: “Janë gjërat për të cilat nuk ka nevojë njeriu, nuk lidhet me to feja e dynjaja e tyre, janë ato që nuk e çojnë tek kënaqësia e Allahut. Janë gjërat e dynjasë pa të cilat njeriu mund të jetojë, dhe pa të cilat besimi i tij nuk do të dobësohej.” (Mirkat el-Mefatih, 8/585)

- Ibën Rexhebi thotë: “Gjërat që nuk kanë të bëjnë me të janë ato për të cilat nuk ka plan e as qëllime, nuk vrapon pas tyre, nëse njeriut i përmirësohet Islami në zemrën e vet, atëherë duhet të largohet nga çdo gjë e cila nuk ka të bëjë me të qofshin ato haramë, dyshime në besim, gjëra të urryera, dhe shumë të tjera, të cilat në fakt edhe pse janë të lejuara mund ta pësojë prej tyre nëse e tepron me to.” (Xhamiul ulumi vel hikem, fq. 201)

- Gazaliu thotë: “Kuptimi i asaj që nuk ka të bëjë me njeriun është p.sh. të flasësh për gjëra të cilat sikur të kishe heshtur për to nuk do të mëkatoje, nuk do të bëhej dëm në trup e as në pasuri, si shembull për të do të përmendja njeriun, i cili ulet me shokët e vet dhe fillon t’ju tregojë për udhëtimet e tij, çfarë ka parë në to nga malet dhe lumenjtë, ngjarjet e veta, ushqimet dhe rrobat e pëlqyera... gjëra këto për të cilat po të heshte nuk do të bënte mëkat. Të folurit në këtë rast, nëse nuk përzihet me gënjeshtër, zmadhime të ngjarjeve, lavdërim të vetvetes, mos marrje nëpër gojë të personave të tjerë etj., e kështu do të ishte mëkat të humbje kohën duke folur dhe se për çdo fjalë do të japësh llogari Ditën e Gjykimit. Në vend që t’i flisje këto gjëra dhe ta përmendje Allahun me dhikër, po ta madhëroje Atë, po të meditoje rreth krijesave të Tij do të përfitoje aq shumë, sa mund të hapej porta e mirësive të Zotit e kështu të përfitoje aq shumë derisa të mëshiroheshe nga Ai. Sikur ta përmendje Allahun vetëm me fjalën “Subhanallah” për secilën prej tyre do të ndërtohej nga një pallat në xhenet.” (Tuhfetul ahvedhij, 7/ 23).■

REPUBLIKA E BURKINA FASOS

SHKRUAN: DRITON LEKAJ

Burkina Faso kufizohet me gjashtë shtete: Malin në veri, Nigerinë në lindje, Beninin në jug-lindje, Togon dhe Ganën në jug, dhe Bregun e Fildishtë në jug-perëndim. Dikur e quajtur “Republika e Voltës së Epërme“, u riemërua më 4 Gusht 1984, nga Presidenti **Thomas Sankara**, Burkina Faso. “Burkina” ka kuptimin sipas gjuhës More “Burrat e nderit” kurse “Faso” sipas gjuhës Diola ka kuptimin “shtëpia e babait” e që rezulton me kuptimin “Vendi i njerëzve të ndershëm”. Gjuhët More dhe Diola janë gjuhët kryesore vendase. Vendasit njihen



Të dhëna të përgjithshme:

Emri i plote: Republika e Burkina Fasos
 Kryeqyteti: Uagadugu.
 Sipërfaqja: 274.400 km²
 Banorët deri më 2005: 13.228.000 milionë.
 Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 3.109 %
 Përqindja e muslimanëve: 65 %
 Gjuha zyrtare: Frënge (More dhe Diola janë dy gjuhë rajonale të pranuar)
 Monedha: Frangu i Afrikës së Mesme
 Pavarësia: 5 Gusht 1960.
 Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 20 Shtator 1960
 Anëtar i Konferencës Islamike: 1974

si burkinas.

Burkina Faso gjendet në pjesën e Afrikës perëndimore si dhe nuk ka dalje në Oqeanin Atlantik e vetmja dalje e saj është nëpërmjet Ganës dhe Bregut të Fildishtë.

Burkina Faso “Volta e Epërme” ishte pjesë e mbretërisë muslimane të “Malit” e pastaj u nënshtrua mbretërisë “Sinfi” gjithashtu edhe kjo muslimane. Pas shpartallimit të dy shteteve u formua një mbretëri në Voltë dhe e vendosi qytetin **Uagadugu** si kryeqendër të saj. Vendi u nënshtrua nga kolonializmi francez në kohën kur ata hynë në Afrikë dhe me anë të marrëveshjes së vitit 1896 u bashkëngjit kolonisë së Senegalit të epërm. Më pas u bë koloni e pavarur dhe u njoh me

emrin “Volta e Epërme”. Nga emri kuptohet se në të kalon lumi Volta, i cili ndahet në tri pjesë: Volta e zezë, e bardhë dhe e kuqe dhe në flamurin kombëtar të saj i ka të tri ngjyrat që simbolizojnë tri pjesët e lumit. Kur muslimanët u munduan të fitojnë pavarësinë toka e tyre u nda mes tri shteteve: Bregut të Fildishtë, Malit dhe Nigerit. Në vitin 1947 Volta e Epërme e riktheu bashkimin e tokave të tyre në një koloni të vetme e më pas më 1960 e arriti pavarësinë nga Franca. “Volta e Epërme” u përdor si emërtim gjer më 4 gusht 1984, kur u ndryshua nga kryetari Sankara, si edhe u ndryshua flamuri kombëtar e stema.

Nuk ka statistika të sakta për sa i përket përqindjes së shtrirjes së feve në Burkina Faso, por sipas statistikave të qeverisë të vitit 1996 thuhet: 70 % e popullsisë janë muslimanë, 16,6% janë katolikë, 3% janë protestantë dhe 23,7% pasojnë besimet vendore.

Islami ka arritur në shekullin e nëntë sipas Hixhretit përmes rrugëve tregtare nga brenda Nigerit e gjer në pyjet tropikale.

Burkina Faso është njëra ndër vendet me GDP më të ulët në botë, saqë radhitet si vendi i tretë në botë për nga varfëria. Ekonomia e saj mbështetet më së tepërmi në bujqësi dhe kjo përbën 32% të prodhimit vendas dhe me bujqësi merren rreth 80% e popullsisë. Aty prodhohet misër, fasule, pambuk, oriz, etj. Blegtoaria është e zhvilluar dhe pjesën kryesore e zënë lopët, dhitë dhe delet. Për sa i përket lopëve rritja e tyre është e zhvilluar në një nivel shumë të lartë.

Gjithashtu nxirren minerale të ndryshme si bakër, hekur, mangan dhe mbi të gjitha ar.

Ky nivel i ulët i zhvillimit ekonomik ka sjellë problemet e veta e sidomos emigracionin drejt vendeve fqinje, por më shumë drejt Amerikës Latine dhe Bregut të Fildishtë. Ky numër i madh emigrantësh ka provokuar shpeshherë tensione në vendet mikpritëse. Pjesa më e madhe e zhvillimit ekonomik mbështetet në ndihmat ndërkombëtare. ■

REPUBLIKA E ÇADIT

Të dhëna të përgjithshme:

Emri i plote: Republika e Çadit.

Kryeqyteti: N`Xhamena.

Sipërfaqja: 1.284.400 km²

Banorët deri më 2007: 10.780.600 m.

Përqindja vjetore e rritjes së banorëve
(2000 - 2005): 3.109%

Përqindja e muslimanëve: 65 %

Gjuha: Frënge dhe Arabe.

Monedha: Frangu i Afrikës së Mesme
(CFA Franc)

Pavarësia: 11 Gusht 1960.

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 20 Shtator 1960

Anëtar i Konferencës Islamike: 1969



Çadi ndodhet në pjesën qendrore-vertiore të **Afrikës**. Çadi në veri kufizohet me **Libinë**, në lindje me **Sudanin**, në jug me **Republikën e Afrikës Qendrore**, në jug-perëndim me **Kamerunin** e **Nigerinë** dhe në veri-perëndim me **Nigerin**. Për shkak të klimës së saj të shkretëtirës shpeshherë i referohen me emërtimin “Zemra e vdekur e Afrikës”.

Republika e Çadit është urë lidhëse mes shteteve në veri të Afrikës dhe shteteve afrikane të jugut apo perëndimit. Çadi ka qenë një ndër vendet islame më të rëndësishme në Afrikë, sepse pozita e tij strategjike mes shteteve arabe dhe afrikane e ka bërë atë pikën e takimit të

kulturave islame me ato afrikane marrë në përgjithësi. Islami ka hyrë në Çad nëpërmjet tregtarëve të Al-Tebut në veri dhe nga lindja përmes tregtarëve prej Al-Vadit dhe Sudanit gjatë shekullit të 13. Thirrësit në Islam e kanë konsideruar Çadin, si pikënisje për shumë karvanë në përhapjen e Islamit. Për sa i përket përqindjes së muslimanëve në Çad ka dallime mes statistikave, por padyshim popullsia muslimane përbën shumicën e banorëve të Çadit.

Franca e kolonizoi Çadin në vitin 1920 dhe ia bashkëngjiti atë Afrikës Ekuatoriale Franceze. Çadi është themeluar si shtet nga territoret koloniale franceze në Afrikë të mbajtura deri në vitet 1960-ta. Pas pavarësisë në shtetin e krijuar zotëronin konfliktet etnike, të cilat për një kohë të gjatë i errësoi ndërhyrja libiane para paqes që dukej e largët në horizont, e cila u restaurua më 1990.

Gjatë vitit 1998 në pjesën veriore të Çadit shpërthyen dy rebelime, të cilat sollën dy marrëveshjet e viteve 2002 dhe 2003, ndërmjet rebelëve dhe qeverisë. Me gjithë reformat fuqia e vendimeve duket se ka mbetur në duart e parisë veriore, e cila është ndjeshme ndaj dallimeve etnike.

Në përgjithësi vendi është përfshirë nga kriza të njëpasnjëshme dhe ajo që ndodhi në vitin 2008, lufta e ashpër në kryeqytet mes

rebelëve dhe qeverisë është dëshmitari më i mirë. Gjithashtu fluksi i madh i refugjatëve e që sipas OKB-së janë të ndarë në: 280.000 nga Darfuri, 50.000 prej Republikës së Afrikës Qendrore dhe mbi më se 170.000 të shpërngulur brenda përbrenda Çadit, e bëjnë situatën edhe më të vështirë.

Sipas OKB-së Çadi radhitet si vendi i pestë për nga varfëria në botë, ku 80% e popullsisë jetojnë në skamje. Më 2006 qeveria e Çadit dhe Banka Botërore nënshkruan një memorandum sipas të cilit qeveria do të angazhohet për shpenzimin e 70 % të hyrjeve në programet e zvogëlimit të varfërisë.

Çadi ka pasuri minerale, si nafta e cila filloi të eksportohet më 2003, gjithashtu ka rezerva të mëdha ari, hekuri, uraniami, zinku, mermeri prej të cilave shteti nuk ka përfituar deri më tani.

Prodhimet më të rëndësishme bujqësore janë: orizi, pambuku, misri, mëndafshi, kikiriku, pemët frutore, si portokalli dhe mango. Çadi ka pasuri të mëdha në rrafshin e blegtorisë, si lopë, dele dhe deve, saqë eksporton drejt shteteve të Afrikës së mesme dhe perëndimore, si dhe drejt vendeve të tjera.

Peshkimi bëhet në liqenin e Çadit dhe në lumenjtë. Nuk ka ndonjë industri të mirëfilltë, partnerët më të rëndësishëm të tregtisë llogariten të jenë Franca dhe Nigeria. ■





SHPREHJET E KËQIJA DHE PASOJAT E TYRE

NGA: ALI SHABANI

Pyetje: Hoxhë i nderuar, duke pasur parasysh parimet e Fesë Islame dhe se kjo fe i ka dhënë pozitë të lartë moralit, si e gjykon kjo fe shprehjen vulgare.

Përgjigje: Në emër të Allahut Mëshirëplotit, Mëshirëbërësit, që e ka bërë në fenë e tij Islamit, të gjykohen rreptë shprehjet e këqija dhe i ka ndaluar. Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”* Nahël 90, ndërsa shejtani bën të kundërtën. Allahu i Madhëruar ka thënë:

“...e mos shkoni hapave të djallit se ai është armik i hapët i juaji. Ai ju urdhëron vetëm me të këqija e paturpësi, dhe ju shtyn të thoni për Allahun atë që nuk e dini.”

Bekare 169. Pra, kushdo musliman që ia lejon vetes të flasë fjalë vulgare dhe amorale, që është diçka e shëmtuar për çdo njeri e për më tepër për muslimanin, le ta dijë se ka rënë nën ndikimin e shejtanit dhe po ashtu ka rënë në ndalesën e Allahut dhe kështu po bën mëkat për të cilin ai duhet të pendohet. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë: *Kush i beson Allahut dhe Ditës së Gjyimit, le të flasë mirë, ose përndryshe le të heshtë!*

Pyetje: Çfarë duhet të bëjmë, apo çfarë mase duhet të marrim kur ndodh që në

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

mesin e shokëve ndonjëri përdor shprehje vulgare?

Përgjigje: Pa dyshim duhet këshilluar ai shok, se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *Feja është këshillë... nëse në zemrën e tij ka iman, ajo këshillë do t'i bëj dobi, sepse Allahu i Madhëruar thotë: "Vazhdo me këshillë, sepse këshilla u bën dobi besimtarëve."* Dharijat 55.

Nëse ai nuk e ndërpret dhe vazhdon me shprehje të fëlliqura, sharje, fjalë të ndyra që shkakton largimin e të tjerëve nga ai, atëherë ka rënë në një gjendje shumë të keqe. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *"Me të vërtetë njerëzit me pozitë më të keqe tek Allahu janë ata nga të cilët, të tjerët largohen duke u frikësuar (ruajtur) nga imoraliteti (vulgariteti) i tyre.* Shënojnë Buhariu dhe Muslimi. Po ashtu ka thënë: *Allahu urren atë që bën dhe shprehet me fjalë vulgare dhe imorale.* (Shiko Sahih xhamius-sagir nr. 134)

Ata që nuk lënë shprehjet e këqija, nuk është mirë të shoqërohesh me ta, se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *"Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj le të shikojë ai se cilin bën shok."*

Pyetje: Te populli ynë është e zakonshme, që në zënkë e sipër të shprehin fjalë të ndyra dhe sharje, ku marrin nëpër gojë prindërit e njëri-tjetrit, apo anëtarët e tjerë të familjes. Çfarë thotë Kurani dhe hadithi në lidhje me këta?

Përgjigje: Ndodh që njerëzit të kenë mosmarrëveshje ndërmjet tyre për ndonjë çështje, apo të zihen, por megjithatë nuk është burrëri që nga zemërimi dhe mllëfi që kanë të marrin nëpër gojë nderin e njëri-tjetrit dhe aspak nuk është nga Islami. Allahu i Madhëruar ka thënë: *"E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtarët, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me një mëkat shumë të madh."* Ahzab 58.

Po ashtu këto shprehje janë nga mëkatet e mëdha. I Dërguari i Allahut ka thënë: *"Me të vërtetë nga mëkatet e mëdha është që dikush t'i shajë prindërit e vet."* Të pranishmit thanë: *O i Dërguari i Allahut, po kush i shan prindërit e vet?!...* *"Po, e shan babën e tjetrit, e pastaj ai ia shan babanë atij, ia shan nënën, e pastaj ai ia shan nënën atij."* Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *"Sharja e muslimanit është fisk (shfrenim)..."*

Pyetje: Çfarë dënimi kanë ata që marrin nëpër gojë, apo shajnë nderin e muslimanit?

Përgjigje: Ata që shajnë dhe e përgojnë nderin e muslimanit kanë rënë në mëkat dhe kanë dënim në dynja dhe Ahiret. Allahu i madhëruar ka thënë: *"E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtarët, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me një mëkat shumë të madh."* Ahzab 58. Për sa i përket dënimit në dynja, me Sheriat duhet të dënohet me goditje me shkop në shpinë, ndërsa në Ahiret Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem tregon, se kur është ngritur në qiell, në Miraxh ka kaluar parë disa njerëzve që kishin thonjë prej bakri dhe gërvishtnin fytyrat dhe gjokset e tyre. Pejgamberi e pyet Xhibrilin: *"Kush janë këta, o Xhibril?"* *"Këta janë ata që hanë mishin e njerëzve dhe përfolën nderin e të tjerëve."* Shënojnë Ahmedi dhe Ebu Davudi

Pyetje: Më parë në vendin tonë, kur donin të thoshin për ndonjë njeri se është i drejtë, thoshin "ky komunist", e sot me sistemin demokratik, kur dëshirojnë të thonë për ndonjë njeri se është i rrafshët dhe nuk i shikon imtësitë thonë: "ky është demokrat" me qëllim për ta lavdëruar. Çfarë na thoni në lidhje me këtë?

Përgjigje: Nuk lejohet që besimtari të emërtohet me këto emra të shëmtuar, që

në vetvete përmbajnë ateizëm, apo shirk, por edhe janë “besnikë” ndaj imoralitetit dhe po ashtu edhe komunizmi dhe demokracia janë sisteme të shfrenuara të kufrit, e si dikush me këto emra ta lavdërojë besimtarin. Allahu na ruajt nga padituria dhe kurthet e shejtanit.

Pyetje: Disa, pasi vdes ndokush, flasin çmos për të. E dimë se përgojimi është i ndaluar për të gjallët, por a vlen ajo ndalesë për të vdekurit?

Përgjigje: Ashtu siç nuk lejohet të përgojohen të gjallët, nuk lejohet të përgojohen as të vdekurit. I Dërguari i Allahut ka thënë: *Mos i shani të vdekurit, sepse ata i kanë mbyllur veprat që kanë bërë.* (atë që meritojnë do ta marrin dhe nuk ka nevojë që dikush ta ngarkojë veten me të). Kjo edhe i irriton të gjallët e familjes së të ndjerit dhe mund të shkaktojë probleme të mëtejshme. Në Medinë ishin të pranishëm edhe një shtresë tjetër, mynafikët. Ata i dinte me emra vetëm Hudhejfeja radijallahu anhu, mirëpo kur vdiste ndonjëri nga ata munafikë, Hudhejfe vetëm largohej dhe nuk merrte pjesë në faljen e xhenazes, por assesi nuk ka dalë të flasë në mesin e njerëzve, se filan i vdekuri ka qenë nga munafikët.

I Dërguari i Allahut gjithashtu ka thënë: *“Përmendni veprat e mira të vdekurve tuaj dhe ndaluni nga përmendja e veprave të këqija të tyre.”* Hadithi ka dobësi në sened, por ka hadith – dëshmi nga Aisheja në përmbledhjen e Nesaiut me sened Xhejid.

Pyetje: Nëse njeriu është nga ata që falen rregullisht dhe i përmbahet rregullave fetare në përgjithësi, mirëpo në fjalorin e tij hasen shprehje të këqija vulgare, sharje etj. Si e ka hallin ky person?

Përgjigje: Allahu na ruajt nga kjo gjendje, besimtar që falet, por moralin ta ketë të keq! Ebu Hurejre tregon se e kanë

pyetur të Dërguarin e Allahut për një grua? O i Dërguari i Allahut, filania falet edhe natën, agjëron ditën, mirëpo me gjuhën e saj i pengon fqinjët, duke ushtruar tirani ndaj tyre. Pejgamberi për këtë tha: *“S’ka hair në te, ajo është në Zjarr”.*

Pyetje: Disa kur flasin fjalë të ndyra, apo shajnë, kur këshillohen, ata argumentohen se Ebu Bekri ka përdorur fjalë të ndyta. Ata thonë edhe se Ebu Bekri ka sharë në prani të Pejgamberit, e Ai salAllahu alejhi ue selem nuk i ka thënë gjë.

Përgjigje: Këta që veprojnë kështu kanë bërë shpifje të madhe ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, ndaj Ebu Bekrit dhe bëjnë padrejtësi të madhe. Këta janë zullumqarë shpifës. I shtrembërojnë argumentet dhe kjo sjellje e tyre u ngjan çifutëve. Së pari, këta kanë lënë anash të gjitha argumentet, që flasin për moralin dhe për braktisjen e fjalëve të ndyta dhe argumentohen me rastin e Ebu Bekrit për t’u sharë kur të dëshirojnë?! Ebu Bekri në përballjen me mushrikët që provokuan muslimanët para betejës së Bedrit, ua ktheu atyre duke iu thënë “Shkoni lëpijani organin idhujve tuaj!” Përveç kësaj nuk dihet që Ebu Bekri të ketë përdorur më fjalë të ndyra. Këtë rast disa mendjelehtë e përdorin si argument për t’u sharë kur të duan dha si të duan. Më e keqja është se kur i këshillon, ata menjëherë ta presin: Ebu Bekri ka sharë. Sa e shëmtuar që e marrin Ebu Bekrin radijallahu anhu si shembull për sjelljet e tyre të këqija. Allahu i udhëzoftë. Ebu Bekri radijallahu anhu me epitetet më të dalluara në këtë umet në të gjitha sferat, disa e marrin si shembull i të shfrenuarve. Allahu i Madhëruar ka thënë: *“A do t’i bëjmë kriminelët të barabartë me muslimanët? Ç’është me ju, si gjykoni ashtu?”* Kalem 35-36. ■

KUSH LË NJË TË KEQE ALLAHU I JEP NJË TË MIRË

Ubej b. Kabi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ka thënë: “S’do mend se kur një rob lë diçka për hir të Allahut, Allahu ia zëvendëson atë me diçka më të mirë prej nga ai s’e kujton. Nga ana tjetër ai që zgjedh një të keqe Allahu i çon një vështirësi më të madhe.” E përcjell Vakiu në “Zuhd”.

IBRAHIM B. ABDULLAH EL HAZIMI

Ubej b. Kabi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ka thënë: “S’do mend se kur një rob lë diçka për hir të Allahut, Allahu ia zëvendëson atë me diçka më të mirë prej nga ai s’e kujton. Nga ana tjetër ai që

zgjedh një të keqe Allahu i çon një vështirësi më të madhe.” E përcjell Vakiu në “Zuhd”.

Në përgjithësi Allahu nëse ka ndaluar diçka, ka lejuar një tjetër duke e zëvendësuar me një më të mirë se ajo. Për shembull Allahu e ndaloi kamatën, mirëpo e lejoi tregtinë e mirëfilltë.



E ndaloi bixhozin mirëpo i lejoj garat e dobishme me kuaj, deve dhe shigjeta.

E ndaloi mëndafshin për burrat, mirëpo i lejoj të gjitha materialet e tjera për veshmbathje.

E ndaloi kurvërinë, mirëpo e lejoj kurorën me gra të bukura.

E ndaloi alkoolin, mirëpo i lejoj pijet e shijshme joalkoolike të dobishme për trupin dhe shpirtin.

I ndaloi instrumentet muzikore, mirëpo këtë e zëvendësoi më dëgjimin e Kuranit Madhështor.

I ndaloi ushqimet e papastra, mirëpo i lejoj ushqimet e mira.

Prej mrekullisë hyjnore është se shëndeti dhe e mira të jenë shpërblimi i ndershmerisë, kurse sëmundja dhe e keqja të jenë dënimi i pandershmerisë.

Ky shkrim përmban disa tregime, të cilat i shkrova me shpresë për të bërë dobi. Lus Allahun e Madhëruar që të kenë një pranim në mesin e muslimanëve.

Këtë shkrim e titullova “Kush lë diçka për hir të Allahut, Allahu atë ia zëvendëson me një më të mirë”, që është pjesë e një hadithi.

Këto tregime janë për disa njerëz që e kuptuan madhësitë e Allahut, patën frikë prej Tij, për ata të cilët gjithnjë parafytyronin Ditën e Daljes para Allahut. Atë ditë në të cilën nuk bën dobi as pasuria, as fëmijët. Bëhet fjalë pra, për njerëz të cilët morën në konsideratë Kuranin, Sunetin dhe devotshmërinë. Ata e meritojnë që të ndajmë një pjesë të kohës tonë për t'i lexuar ngjarjet e tyre. Më këto rreshta i drejtohem të gjithë muslimanëve, të vjetër e të rinj, meshkuj e femra, në veçanti ju drejtohem të rinjve që praktikojnë fenë dhe të gjithë atyre që i dhanë përparësi kënaqësisë së Allahut ndaj kënaqësisë vetjake e djallëzore.

1. **Sulejmani, alejhi selam**, theri kuajt e tij për hir të Allahut, e Allahu ia zëvendëson këtë me kontrollimin e erës, e cila shkon kudo.

Allahu i madhëruar thotë: **“Ne Davudit i falëm Sulejmanin, rob shumë i mirë dhe shumë i kthyer nga Zoti. Kur në një parabrëmje iu shfaqën atij kuaj, që kur ishin të ndalur, rrinin gatitu në tri këmbë, e ishin edhe shumë të shpejtë. E ai tha: “Unë i dhashë përparësi dashurisë së kuajve, ndaj Zotit tim, derisa (dielli) u fsheh dhe perëndoi”. “M’i ktheni ata mua!” Atëherë filloi t’u mëshojë këmbëve e qafave.”** (Sad: 30-33) Allahu i Madhëruar përmend në këto ajete, se Davudit i dhuroi Sulejmanin. Pastaj atë e lavdëroi se ishte nga ata që pendohej dhe kthehej tek Allahu çdoherë. Pas kësaj përmendi rastin me kuajt. Tregimi i plotë është kështu:

Sulajmani, alejhi selam, ishte shumë i pasionuar pas kuajve për shkak të xhihadit në rrugë të Allahut. Ai kishte kuaj të fuqishëm e të shpejtë. Kuajt ishin me flatra, kurse numri i përgjithshëm që ai zotëronte ishte njëzetmijë. Një ditë prej ditëve, ndërsa ai po merrej me kuajt e tij i kishte ikur namazi i ikindisë me harresë. Kur i ra ndërmend se koha e namazit kishte kaluar për shkak të kuajve ai tha: Pasha Allahun, nuk do të më angazhojë më, gjë tjetër nga adhurimi i Zotit tim! Pas kësaj ai urdhëroi të theren të gjithë kuajt. Si shpërblim për këtë Allahu i Madhëruar i dhuroi kontrollimin e erës, e cila nën drejtimin e tij do të qarkullonte kudo. Largësia që do arrinte era ishte një muaj. Allahu i fali atij diçka që ishte më e shpejtë dhe më e mirë. Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë të vërtetën kur shpalli këto fjalë: **“Kur të lësh diçka për hir të Allahut, Allahu do të dhurojë diçka më të mirë.”** Ahmedi dhe Bejhekiu

2. Hoqi dorë nga kurvëria e Allahu i fali mbretëri dhe grua të ndershme:

Jusufi, biri i Jakubit, alejhima selam, është një i dërguar i Allahut tregimin e të cilit e përmend Allahu hollësisht në Librin e Tij, në kaptinën që mban emrin e këtij pejgamberi. Nga ky tregim dijetarët nxjerrin dobi të shumta, madje edhe duke kaluar mijëshen. Ky pejgamber fisnik u vu në një sprovë të rëndë, mirëpo ai duroi ngaqë kështu veprojnë të devotshmit. Sprova iu shndërrua në një begati të madhe hyjnore. Tregimi i tij është kështu:

Nëna e Jusufit quhej Rahila. Ai kishte njëmbëdhjetë vëllezër. Babai i tij e donte pa masë, për këtë vëllezërit e tij filluan ta kenë edhe zili. Ata ishin të gjithë së bashku, kurse me Jusufin ishte vetëm njëri vëlla Beniamini, i cili gëzonte po ashtu dashurinë e madhe të babait të tij. Ç'ndodhi pas kësaj? Ata i kërkuan babait të tyre, që ta lejonte Jusufin një ditë me ta për të shëtitur, duke i thënë se ata dëshironin të argëtoheshin së bashku me vëllanë e tyre, mirëpo në fakt fshihnin diçka tjetër, një gjë që Allahu e dinte. E morën vëllanë e tyre dhe e hodhën në një pus. Pastaj aty kalon një karvan dhe dikush prej udhëtarëve lëshoi enën në pus për të nxjerrë ujë. Jusufi, alejhi selam, u kap për litari dhe doli nga pusi. Me të arritur në Egjipt fëmija i gjetur i shitet një funksionari të lartë egjiptian. Çmimi i tij ishte vetëm disa dërrhem. Pas kësaj ç'ndodhi? Allahu i Madhëruar tregon: ***“E ajo, në shtëpinë e së cilës ishte Jusufi, i bëri lajka atij dhe ia mbylli dyert e i tha: “Eja!”. Ai (Jusufi) tha: “Allahu më ruajt, zotëria im (e burri yt) më nderoi me vendosje të mirë (si mund t'i bëj hile në familje)?”. S'ka dyshim se tradhtarët nuk kanë sukses. Ajo e mësyu atë qëllimisht, e atij do t'i shkonte mendja ndaj saj, sikur të mos i paraqitej argumenti nga Zoti i tij.***

Ashtu (e bëmë të vendosur) që ta largojmë nga ai të keqen dhe të ndyrën. Vërtet, ai ishte nga robërit tanë të zgjedhur.” (Jusuf: 23-24)

Allahu i Madhëruar na rrëfen atë që deshi bashkëshortja e zotërisë së Jusufit, pra, ajo kërkoi prej tij një gjë që s'kishte hije, që s'përputhej me gjendjen e tij, edhe pse ajo ishte tejet e bukur, tërheqëse dhe me pozitë të lartë. Ajo u stolis e u zbukurua pastaj i mbylli dyert, megjithatë ishte gruaja e vezirit. Jusufi, alejhi selam, ishte një djalosh i bukur e i pashëm. Dihet shumë mirë fuqia e epshit tek i riu. Ai ishte beqar, në një vend të huaj, larg familjes dhe vendit të tij. Dihet mirëfilli se kur njeriu nuk është në mesin e atyre që e njohin gjasat për të bërë gabime janë më të mëdha. E para, që kërkoi çnderimin ishte ajo grua e bukur, që mënjanonte përgjegjësinë e burrit për të kërkuar i pari dhe të priste një refuzim të mundshëm. Ata gjendeshin në një vend, ku nuk mund t'i shihnin të tjerët dhe me gjithë këto shtytës për të bërë haram, Jusufi, alejhi selam, u përmbajt dhe Allahu e mbrojti nga amoraliteti. Ai rridhte nga një familje pejgamberësh dhe Allahu e mbrojti nga kurthi i grave. Për këtë e shpërbleu me një post të lartë në pushtetin e mbretit të Egjiptit. Ai u martua sipas normave të sheriatit me atë grua dhe kur hyri në gjerdek i tha: “Kjo është më e mirë për ty, se ajo që dëshirove më parë.”

Mendo i nderuar vëlla musliman, se si e shpërbleu Allahu pas lënies së mëkatit. Për këtë arsye Jusufi, alejhi selam, është zotëria i njërit prej shtatë grupeve të devotshmëve, të cilët do të jenë nën hijen e Allahut atë ditë kur nuk ka hije tjetër pos hijes së tij. Buhariu dhe Muslimi shënojnë se Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: ***“Shtatë grupe njerëzish do të jenë nën hijen e Allahut atë ditë kur***

nuk ka hije tjetër pos hijes së tij: prijësi i drejtë, njeriu që e përmend në vetmi Allahun dhe i mbushen sytë me lot, njeriu që e ka zemrën të lidhur me xhaminë, dy njerëz që duhen për hir të Allahut dhe për këtë bashkohen ose urrehen për hir të Allahut dhe për këtë ndahen, njeriu i cili jep një lëmoshë dhe e majta e tij nuk e di se ç'ka dhënë e djathta e tij, i riu që jetën ka filluar duke adhuruar Allahun dhe njeriu të cilin e thërret një grua e bukur e me pozitë kurse ky i thotë: unë i frikësohem Allahut.”

3. Shpërblimi i durimtarit:

Besimtari i nënshtrohet sprovave të ndryshme në këtë botë, prandaj duhet që kur të sprovohet të jetë durimtar dhe të shpresojë shpërblim prej Allahut, sepse Allahu nuk i humbet atij asgjë, porse ia zëvendëson atij me diçka më të mirë. Në lidhje me këtë Muslimi shënon një tregim me Umu Selemen, radijAllahu anha, e cila rrëfen: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: *“Çdo musliman që e godet një fatkeqësi dhe thotë: “Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem, o Allah më shpërble pas kësaj fatkeqësie dhe ma zëvendëso atë me diçka më të mirë” Allah do t’ia zëvendësojë me një gjë më të mirë.”* Umu Seleme vazhdon: Kur më vdiq bashkëshorti thashë më vete: Kush prej muslimanëve është më i mirë se bashkëshorti im Ebu Seleme?! Shtëpi e parë që bëri hixhret për tek i Dërguari i Allahut?! Mirëpo unë e thashë atë lutje e Allahu ma dhuroi të Dërguarin e Allahut si bashkëshort.

E sheh vëlla musliman: Kush lë diçka për hir të Allahut, Allahu i jep një tjetër më të mirë. Kush i lë shuplakat fytyrës së vet, shqyerjen e rrobave dhe vajtimin në rastin kur e godet ndonjë fatkeqësi dhe i lë

haramet e tjera, shpreson tek Allahu, e thotë lutjen e duhur, Allahu ia zëvendëson humbjen e tij me diçka më të mirë.

4. Jahja b. Ejubi rrëfen:

Në Medine ishte një djalosh të cilin Omeri, radijallahu anhu e simpatizonte shumë. Një ditë me të kthyer djaloshi prej namazit të jacisë i doli përpara një grua dhe e joshi për amoralitet. Djaloshi u mashtrua dhe u nis me të. Eci pas asaj gruaje derisa arriti te shtëpia e saj. Djaloshi ndjeu një dhimbje në zemrën e vet dhe i ra në mendje ajeti: **“Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë (Allahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën).”** (Araf, 201), dhe kur po kujtonte ajetin kuranor djaloshi alivanoset. Gruaja që e ftoi atë e shikoi me vëmendje, mirëpo djaloshi dukej si i vdekur. Ajo së bashku me shërbëtoren e vet e zvarritën derisa e hodhën djaloshin në pragun e shtëpisë së vet. Doli babai i tij e mori djalin dhe e futi brenda. Pas një farë kohe djaloshi u kthjellua. Babai i tij e pyeti se ç’i kishte ndodhur? Ai në fillim nuk desh t’i tregonte, mirëpo më vonë i tregoi të vërtetën. Duke i treguar babait arriti te ajeti kuranor dhe filloi ta lexojë atë. Duke e lexuar lëshoi një klithje të madhe dhe i doli shpirti. Kur dëgjoi Omeri, radijallahu anhu, rastin e tij u tha shokëve: “Përse nuk më keni lajmëruar për vdekjen e tij?!” Shkoi te varri i tij dhe i thirri: “O filan: **“E për atë që pati frikë paraqitjen para Zotit të vet, janë dy xhenete.”** (Rahman: 46), pas këtyre fjalëve Omeri dëgjoi një zë që vinte nga varri: “Një gjë të tillë ma dhuroi Zoti, o Omer”. ■

Përktheu: Agim BEKIRI